SILVANA NINI

# LIBËR MËSUESI
# ARTI PAMOR 9

BOTIME

pegi

**BOTIME**

pegi

Redaktor letrar: Arlon Liko
Paraqitja grafike: Lindita PRELA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë

**Botime Pegi:** tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
**e-mail:** botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
**Sektori i shpërndarjes: cel:** +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
**e-mail:** marketing@botimepegi.al
**Shtypshkronja Pegi**: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

# Përmbajtja


## 1. Hyrje ..........................................................................5

1.1 Pse shërben ky libër? ..........................................................................5

1.2 Çfarë synon ky libër? ..........................................................................5

1.3 Çfarë përmban ky libër?..........................................................................6

## 2. Kompetencat dhe kuptimi i tyre ....................................6

2.1 Kuptimi dhe zbatimi i kompetencave lëndore dhe i tematikave që zhvillohen në lëndën e Artit pamor..........................................................................7

2.2 Lidhja e lëndës së artit pamor me fushat e tjera kurrikulare..........................12

## 3. Planifikimi i kurrikulës – kuptimi dhe zbatimi...........13

3.1 Plani vjetor i lëndës "Art pamor", sipas tremujorëve ....................................14

3.2 Planifikimi tematik për tremujorin e parë (shtator-dhjetor) ..........................16

3.3 Planifikimi ditor bazuar në situata të të nxënit (shtator-dhjetor) ..................23

3.4 Planifikimi tematik për tremujorin e parë, (janar-mars)................................40

3.5 Planifikimi ditor bazuar në situata të të nxënit (janar-mars) ........................47

3.6 Planifikimi tematik për tremujorin e parë (prill-qershor)..............................61

3.7 Planifikimi ditor bazuar në situata të të nxënit (prill-qershor).......................68

**4. Metodologjia e mësimdhënies ......................................81**

4.1 Metodologjia e të nxënit dhe e mësimdhënies bazuar në kompetenca në lëndën e artit pamor.......................................................................................81

4.2 Materiale dhe burime mësimore ...............................................................82

**5. Vlerësimi ............................................................................84**

5.1 Llojet e vlerësimit: Vlerësimi i vazhdueshëm, periodik dhe përfundimtar......84

# 1. Hyrje

Lënda "Arti pamor" është një lëndë e veçantë me kërkesat e veta specifike të të mësuarit. Veprimtaritë e "Artit pamor" bëjnë të mundur që nxënësit të bëjnë lidhjen midis botës reale dhe asaj imagjinare, të organizojnë dhe të shprehin vizualisht idetë, ndjenjat dhe përvojat nëpërmjet teknikave të larmishme artistike.

Edukimi nëpërmjet "Artit pamor" siguron zhvillimin e krijimtarisë dhe të përvojave personale nëpërmjet zbulimit, kërkimit, eksperimentimit dhe përdorimit të një sërë mjetesh dhe teknikash artistike. Kjo lëndë promovon vëzhgimin dhe i ndihmon nxënësit/et të fitojnë ndjeshmëri për botën pamore.

Në artin pamor, imazhi mund të marrë forma të ndryshme, në varësi të mjeteve dhe të materialeve që përdoren për ta realizuar atë. Imazhi mund të jetë dy ose tredimensional, abstrakt ose figurativ, dinamik ose statik etj. Ai krijohet duke përdorur teknika të ndryshme artistike. Përzgjedhja e materialeve dhe organizimi i gjuhës pamore në një vepër varen nga mesazhi që ajo do të komunikojë.

Edukimi, nëpërmjet lëndës së artit pamor, nxit zhvillimin e përgjithshëm të nxënësit/es dhe pasuron kulturën e tij/saj. Kjo lëndë i ndihmon nxënësit/et të deshifrojnë mesazhet pamore, të vëzhgojnë imazhet me një ndjeshmëri më të lartë, të ushtrojnë mendimin kritik dhe ndjenjën estetike. Sot, në kulturën edukative i kushtohet shumë rëndësi pranisë së imazhit dhe në këtë drejtim artet pamore luajnë një rol themelor në zhvillimin social, ekonomik dhe artistik të nxënësve/eve.

Duke u mbështetur në kërkesat e programit, libri i artit pamor i klasës së nëntë bazohet në tri kompetenca: krijimi artistik, realizimi i punimit dhe vlerësimi i veprave të artit. Ky libër i orienton nxënësit/et të krijojnë imazhet e tyre, duke u përfshirë në procesin krijues, duke zbuluar mundësi të shumta të kombinimit të materialeve me gjuhën pamore për të komunikuar mendimin e ndjenjat e tyre.

## 1.1 Pse shërben ky libër?

Ky libër do t'u shërbejë mësuesve/eve të artit pamor, si një material mbështetës për të zhvilluar aftësitë e tyre profesionale në këtë lëndë, për zbatimin më së miri të risive në kurrikulën e artit pamor.

## 1.2 Çfarë synon ky libër?

Meqenëse arsimi po zbaton mësimdhënien bazuar në ***kompetenca***, ky libër do të shërbejë si një udhërrëfyes për të gjithë mësuesit/et e artit pamor që do ta ndërtojnë punën e tyre të përditshme bazuar në njohjen e dokumentacionit të ri: *kornizën kurrikulare, kurrikulën-bërthamë të arteve, programin mësimor* dhe vlerësimin bazuar në *nivelet e arritjes së kompetencave në arte,* të cilat përkojnë me tri faza mjaft të rëndësishme:

a) planifikimin e të nxënit;
b) metodologjinë e mësimdhënies;
c) vlerësimin e të nxënit bazuar në qasjen e re me kompetenca.
Qëllimi i këtij libri është t'i orientojë mësuesit/et e klasës së nëntë dhe t'i ndihmojë që të përmbushin synimet e kurrikulës së artit pamor, të ndërtojnë kompetencat lëndore te nxënësit/et e klasës së nëntë, të planifikojnë dhe të realizojnë detyrat e tyre si mësimdhënës/e së kësaj lënde, në përputhje me dokumentet zyrtare dhe me fazat nëpër të cilat kalon mësimdhënia.

### 1.3 Çfarë përmban ky libër?

Ky libër është konceptuar në përputhje me draft-programin e klasës së nëntë, të shkallës së katërt të lëndës "Arti pamor", miratuar nga MAS-i dhe merr përsipër:

- të sqarojë çdo mësues/e të artit pamor për të gjitha çështjet e planifikimit, të metodologjisë dhe të vlerësimit që duhet të zbatojnë ata/ato lëndën e tyre;
- të paraqesë dokumentet e hartuara dhe mënyrën se si ato duhet të përdoren nga vetë mësuesi/ja në lëndën e artit pamor në klasën e nëntë;
- të udhëzojë për të gjitha formatet e reja: planin vjetor, tremujor, ditor, situatat e të nxënit, formatet e vlerësimit etj., me të cilat duhet të punojë mësuesi/ja gjatë një viti shkollor.

Ky libër në parim jep, ofron ose sugjeron modele, por nuk i dikton ato. Çdo model që ka të bëjë me planifikimin, situatat e të nxënit, metodologjinë apo vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të nivelit të klasës ku mësuesi/ja jep mësim. Realiteti në çdo klasë, mund të sugjerojë modele të ndryshme, për tema të caktuara.

## 2. Kompetencat dhe kuptimi i tyre

Kjo çështje ka si qëllim kuptimin:

- për krijimin e kushteve për ndërtimin e ***kompetencave të lëndës*** së ***artit pamor*** si dhe të ***kompetencave kyçe,*** të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën;
- për realizimin e ***temave ndërkurrikulare*** nëpërmjet lëndës së artit pamor, i cili është gjithashtu një përbërësi rëndësishëm i programit të artit pamor;
- për kontributin e artit pamor në shoqëri dhe në jetën e përditshme.

Në këtë modul, gjithashtu, përshkruhet ***lidhja e artit pamor me fushat e tjera kurrikulare***, në mënyrë që kurrikula e arsimit parauniversitar të funksionojë si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor, atë të formimit të nxënësve/eve.
Arti pamor zhvillohet në të gjithë arsimin e detyruar përmes 4 shkallëve, që përfshijnë *arsimin fillor* (AF) klasat 1-5 dhe *arsimin e mesëm të ulët (AMU)* klasat 6-9, pra dy cikle arsimimi, të cilat përfshijnë brenda tyre nëntë vite shkollimi.

Këto katër shkallë grupohen në mënyrë të tillë:

• ***shkalla e parë:*** klasa përgatitore (mosha parashkollore 5-6 vjeçare) – klasa dytë;

• ***shkalla dytë:*** klasa e tretë – klasa e pestë;

• ***shkalla e tretë:*** klasa e gjashtë – klasa e shtatë;

• ***shkalla e katërt:*** klasa e tetë – klasa e nëntë.

## 2.1 Kuptimi dhe zbatimi i kompetencave lëndore dhe i tematikave që zhvillohen në lëndën e Artit pamor

**Qasja e bazuar në kompetenca** është i gjithë procesi i të nxënit që zhvillohet në fushën e arteve në përgjithësi (në të gjitha shkallët) dhe që ndërtohet përmes kompetencave të kësaj fushe, të cilat janë: **krijimi**, **realizimi dhe vlerësimi**. Në të gjitha shkallët e kurrikulës, ato zhvillohen dhe plotësohen më tej me **kompetencat specifike lëndore të artit pamor brenda** fushës së arteve. Kompetencat lëndore të artit pamor lidhen dukshëm dhe në mënyrë logjike e metodike me **kompetencat kyçe**. Ato janë të lidhura ngushtë me tematikat e lëndës së artit pamor dhe zhvillohen nëpërmjet tyre. Zotërimi i artit pamor nënkupton ***zotërimin e kompetencave pamore***, që do të thotë aftësi për të kuptuar, për të gjykuar e për të përdorur artin pamor në një shumëllojshmëri situatash dhe kontekstesh, jo vetëm brenda kontekstit të programit mësimor dhe kërkesave të tij, por edhe në situata të tjera, në të cilat ky art luan ose mund të luajë një rol të rëndësishëm. Me kurrikulën e re, arti pamor është strukturuar me tri (3) kompetenca, të cilat renditen si më poshtë:

***Kompetenca 1***

***Krijimi artistik ka të bëjë me:***

• përdorimin e ideve dhe organizimin e gjuhës pamore në një krijim artistik;

• përdorimin e mjeteve dhe të teknikave artistike për realizimin e ideve nëpërmjet gjuhës pamore;

• vlerësimin e ideve krijuese dhe ndarjen e përvojave me të tjerët.

***Kompetenca 2***

***Realizimi i punimit, ka të bëjë me:***

• kuptimin dhe zbatimin e teknikave të larmishme artistike dy dhe tredimensionale për realizimin e ideve krijuese nëpërmjet gjuhës pamore;

• përdorimin e teknikave dhe të proceseve artistike, si dhe me ndarjen e përvojave me të tjerët.

***Kompetenca 3***

***Vlerësimi i veprave të artit, ka të bëjë me:***

• kuptimin dhe analizimin e veprave artistike, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik, që i përgjigjet kësaj grupmoshe.

*Tabela e kompetencave lëndore të artit pamor dhe përshkrimi i tyre*

| **Kompetencat e artit pamor** | **Përshkrimi i kompetencave lëndore** |
|---|---|
| **Krijimi artistik** | Nxënësi/ja:<br>• përdor ide personale, elementet e gjuhës pamore dhe stimuj për krijim;<br>• zbulon rrugë të ndryshme të kombinimit të elementeve të artit pamor për të realizuar idetë artistike;<br>• përdor hapat e procesit krijues, elementet e artit pamor dhe teknikat artistike;<br>• përzgjedh elementet e duhura për të realizuar idetë artistike në tema të personalizuara;<br>• përmirëson punën, duke u mbështetur tek eksperimenti dhe te zgjidhjet e ndryshme artistike;<br>• analizon burime të ndryshme informacioni dhe qëllimin e tij/saj krijues;<br>• identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në krijim, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur. |
| **Realizimi i pun-imit** | Nxënësi/ja:<br>• përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë në punë dy dhe tredimensionale në art dhe dizajn;<br>• krijon punë origjinale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra ose nëpërmjet kujtesës së tij/saj mbi objektet, njerëzit etj., ose nëpërmjet imagjinatës, duke përdorur mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike;<br>• vlerëson eksperiencat e tij/saj krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit;<br>• zgjedh ide dhe planifikon teknikat dhe mjetet e duhura për realizim;<br>• eksperimenton me mjetet shprehëse të mjeteve dhe teknikave të ndryshme artistike për të materializuar idetë e tij/saj;<br>• analizon teknika të ndryshme artistike për qëllimin e tij/saj krijues;<br>• identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në lidhje me realizimin e punimit, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur. |

| | |
|---|---|
| **Vlerësimi i veprave të artit** | Nxënësi/ja:<br>• analizon dhe interpreton elementet e gjuhës vizuale, organizimin e tyre, teknikën dhe gjininë në një vepër arti;<br>• identifikon dhe vlerëson veprat e artit në aspektin e tyre historik dhe social-kulturor;<br>• identifikon dhe argumenton aspektin shprehës dhe simbolik të veprës së artit, atë të punës së tij/saj dhe të shokut/shoqes, duke shprehur emocionet e tij/saj;<br>• interpreton, argumenton dhe shpreh këndvështrimin e tij/saj për një vepër arti, për një objekt artistik, për punimin e tij/saj dhe atë të shokut/shoqes;<br>• përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar veprat e artit, punën e tij/saj, atë të shokut/shoqes dhe eksperiencën e tij/saj artistike;<br>• identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në vlerësimin e veprave të artit, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur;<br>• kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe të artistit në shoqëri në periudha të ndryshme historike;<br>• identifikon një sërë profesionesh që lidhen me artin pamor dhe me karrierën artistike. |

## Tematikat që përshkojnë lëndën e artit pamor

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e artit pamor synon të përmbushë *tri kompetencat e lëndës*, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës/e duhet të zotërojë gjatë jetës së tij/saj, dhe që arrihen nëpërmjet *tri tematikave kryesore*. ***Tematikat përmbajtjesore***, janë ato tematika që zhvillohen përgjatë programit dhe krijojnë kushte që nxënësi/ja të ndërtojë dhe të zbatojë *njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet* dhe *vlerat*, në funksion të *kompetencave të lëndës* dhe të *kompetencave kyçe*. Për çdo tematikë janë paraqitur njohuritë për secilën klasë të çdo shkalle përkatëse. Përshkrimi i secilës **tematikë** dhe përshkrimi i **kompetencave lëndore**, që duhet të shfaqë nxënësi/ja lidhur me tematikat përkatëse, paraqiten vetëm në nivel shkalle.

| TEMATIKAT E ARTIT PAMOR | KOMPETENCAT E ARTIT PAMOR |
|---|---|
| **Tematika 1: Gjuha dhe komunikimi artistik**<br>Nxënësi/ja:<br>• zbulon elementet e gjuhës vizuale në mënyrë personale dhe i përdor për të realizuar idetë e veta përmes imazheve;<br>• përdor me kompetencë hapat e procesit krijues që nga stimuli, ideja dhe realizimi, nëpërmjet përzgjedhjes së teknikave të duhura artistike;<br>• procesi i eksperimentit është pjesë e rëndësishme e krijimit artistik pasi ndihmon në aftësimin e nxënësit, për të personalizuar tema e subjekte të ndryshme;<br>• personalizimi i temave dhe subjekteve dhe përdorimi i qëllimshëm i elementeve të gjuhës artistike është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit krijues;<br>• bëhet i ndërgjegjshëm dhe i pavarur në përdorimin e gjuhës pamore dhe në komunikimin e ideve origjinale;<br>• zbulon ide të reja, përdor burime të ndryshme informacioni, bën skica dhe përcakton qëllimin krijues. | **Kompetenca 1:**<br>**Krijimi artistik** |
| **Tematika 2: Teknika dhe procese artistike**<br>Nxënësi/ja:<br>• krijon punë dy dhe tredimensionale në art dhe dizajn, nëpërmjet përdorimit të teknikave të larmishme artistike;<br>• zbulon mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, tradicionale dhe digjitale, eksperimenton dhe i përdor me kompetencë në realizimin e punimit;<br>• eksperimenton me efektet e ndryshme të tyre për të realizuar idenë dhe për të dhënë mesazhin për një audiencë të caktuar;<br>• zhvillon aftësitë e tij për të organizuar gjuhën vizuale nëpërmjet teknikave të ndryshme artistike dhe ndan eksperiencat krijuese me të tjerët;<br>• bëhet i ndërgjegjshëm dhe i pavarur në përdorimin e teknikave të ndryshme artistike dhe realizimin e ideve origjinale;<br>• zbulon, gjatë procesit krijues, mundësitë e shumta shprehëse që ofrojnë teknikat artistike dy dhe tredimensionale;<br>• përdor burime të ndryshme informacioni, eksperimenton dhe përcakton qëllimin krijues. | **Kompetenca 2:**<br>**Realizimi i punimit** |

| | |
|---|---|
| **Tematika 3: Historia, arti dhe shoqëria**<br>Nxënësi/ja:<br>• analizon dhe interpreton vepra të ndryshme arti dhe objekte të trashëgimisë kulturore në aspektin historik dhe social-kulturor;<br>• përshkruan, analizon dhe interpreton gjuhën vizuale, teknikën, gjininë dhe subjektin në një vepër arti;<br>• komunikon emocionet dhe gjykimin mbi vepra të ndryshme arti si dhe për punën e tij/saj dhe për atë të shokut/shoqes;<br>• vlerëson aspektet e cilësisë simbolike dhe shprehëse të veprave të artit, duke marrë parasysh kontekstin historik të tyre;<br>• përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar eksperiencën e tij/saj artistike dhe atë që ka mësuar nga kjo eksperiencë;<br>• pasuron perceptimin për mjedisin që e rrethon duke e njohur më mirë atë;<br>• kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri, respekton opinione estetike dhe kritike të ndryshme dhe identifikon një sërë profesionesh që lidhen me artin pamor dhe me karrierën artistike. | **Kompetenca 3:**<br>**Vlerësimi i veprave të artit** |

## 2.2 Lidhja e lëndës së artit pamor me fushat e tjera kurrikulare.

Arti pamor është i lidhur me lëndët brenda fushës së saj, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul. Elementet e artit pamor, ritmi, harmonia, dinamika etj., lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike, si: kërcimin, muzikën, teatrin, por edhe me matematikën, gjuhën, shkencat shoqërore. Nxënësit/et nxiten të bëhen të vetëdijshëm/me për një numër procesesh që lidhen me karakteristikat kryesore të kompetencave kroskurrikulare, të cilat krijojnë lidhje me njohuritë në lëndët e tjera. Kompetencat e artit pamor i mundësojnë nxënësit/et të përdorin informacionin, të zgjidhin problemin, të ushtrojnë mendimin kritik, të zbulojnë metoda pune efektive, të përdorin informacionin dhe komunikimin teknologjik, të zhvillojnë identitetin e tyre personal, të punojnë me të tjerët dhe të komunikojnë në mënyrë të përshtatshme. Kështu që, edhe në këtë cikël, mësuesit/et përmes mësimit të shumë përmbajtjeve mësimore, duhet t'u japin mundësinë nxënësve/eve të konsolidojnë përvojat që ata/ato kanë krijuar dhe që i sjellin në klasë, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm këtyre përvojave. Më poshtë paraqiten disa lidhje ndërlëndore të artit pamor me lëndë të tjera, të para përmes objektivave të njohurive:



# 3. PLANIFIKIMI I KURRIKULËS – KUPTIMI DHE ZBATIMI

Planifikimi i kurrikulës është një proces mjaft i rëndësishëm në punën e mësuesit/es, që zgjat përgjatë gjithë vitit shkollor. Përgatitja e dokumenteve që shoqërojnë punën e tij/saj përgjatë vitit janë të shumta dhe kanë të bëjnë me *planifikimin e kurrikulës* dhe *dokumentet* përkatëse. Planifikimi i këtyre dokumenteve të kurrikulës së re nga mësuesi/ja kërkon: liri, elasticitet dhe përgjegjshmëri në planifikim. Këto dokumente janë:

**1.** plani vjetor i lëndës së artit pamor, sipas tremujorëve;

**2.** plani vjetor tematik.

Planifikimi i planit vjetor dhe tremujor bëhet sipas ndarjes së kohës mësimore që sugjeron programi mësimor i artit pamor, i cili është dhënë në tabelën e mëposhtme.

***Tabela 3: Orë të sugjeruara për çdo tematikë***

| | Gjuha dhe komunikimi artistik | Teknikat dhe procese | Historia, arti dhe shoqëria | Gjithsej orë |
|---|---|---|---|---|
| **Klasa e nëntë** | 10 | 15 | 10 | 35 orë |

Planifikimi vjetor i programit është i ndërtuar me *tremujore*, ku secili tremujor ka një grup të caktuar orësh, në bazë të periudhës kohore të përcaktuar në udhëzimin e çdo fillim viti të ri shkollor.

Temat mësimore në lëndën e artit pamor janë renditur sipas programit, pra çdo tematikë njëra pas tjetrës. Njohuritë ndërthuren në mënyrë mjaft organike me njëra-tjetrën pasi të tria kompetencat pasqyrohen në secilën tematikë.

Më poshtë vijojnë tabelat e:

a) Planifikimi vjetor i lëndës art pamor, sipas tremujorëve

b) Planifikimi tematik për çdo tremujor, i lëndës art pamor

c) Planifikimi ditor

## 3.1 Planifikimi vjetor i lëndës “art pamor”, sipas tremujorëve

| Tematikat | Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave | | |
|---|---|---|---|
| | **shtator-dhjetor**<br>**13 orë** | **janar-mars**<br>**12 orë** | **prill-qershor**<br>**10 orë** |
| 1. Gjuha dhe komunikimi artistik **(10 orë)** | **Vija**<br>- Vija në skulpturë dhe arkitekturë<br>**Forma dydimensionale**<br>- Format pozitive dhe negative<br>**Ngjyrat**<br>- Ngjyrat monokromatike<br>**Tekstura**<br>- Tekstura si mjet shprehës në dizajn<br>**Vëllimi**<br>- Vëllimi dhe mënyrat e paraqitjes në pikturë dhe vizatim<br>**Hapësira**<br>- Perspektiva me tre pika ikjeje<br>**Kompozimi**<br>- Ekuilibri ose pesha pamore<br>- Figura e njeriut | | |
| **2. Teknikat dhe proceset (15 orë)** | **Vizatimi**<br>– Teknikat grafike: lapustilat dhe përdorime të ndryshme<br>**Piktura**<br>– Grafiti urban | **Stampimi**<br>– Teknika stampimi dekorative<br>**Fotografia**<br>– Fotokolazhi<br>**Dizajni dhe prezantimi**<br>– Tekstil dizajni; Fashion dizajni | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | **Skulptura**<br>– **Modelimi** me materiale të ndryshme<br>– **Gdhendja** mbi materiale të buta<br>– **Derdhja** forma pozitive dhe forma negative<br>**Konstruksoni**<br>Maket skene në miniaturë me materiale të ndryshme dhe të riciklueshme | |
| **3. Historia arti dhe shoqëria (10 orë)** | | | **Vepra arti nga periudha të ndryshme**[1]<br>**Zhvillimi i artit:**<br>– Postimpresionizmi<br>– Avangardat artistike (fovizmi, ekspresionizmi, kubizmi, abstraksionizmi, dadaizmi, surrealizmi,)<br>– Arti në gjysmën e dytë të shek. XX (ekspresionizmi abstrakt, pop arti, skulptura, arkitektura)<br>– Arti në Shqipëri në periudhën e ndërtimit të socializmit<br>**Trashëgimi kulturore**<br>– Qytetet muze dhe arkitektura e tyre tradicionale<br>**Ekspozita dhe ngjarje kulturore**<br>– Ekspozita, projekte artistike në klasë, shkollë dhe komunitet<br>**Media**<br>Libra, revista, postera, filma, aparat fotografik, kompjuter etj. |

1 Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme mund të përdoren për të ilustruar njohuritë në tematikat “Gjuha dhe komunikimi artistik” dhe “Teknika dhe procese artistike”

## 3.2 PLANIFIKIMI TEMATIK PËR 3 MUJORIN E PARË SHTATOR – DHJETOR

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:**

- Zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike.
- Gjykon drejt mesazhet, që u adresohet.
- Shprehet qartë dhe saktë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale.
- Komunikon qartë mendimin e tij/saj.
- Shfrytëzon në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese, mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme.

**Kompetenca e të menduarit:**

- Përpunon njohuritë vizuale në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi.
- Zgjidh në mënyrë të pavarur probleme të ndryshme artistike.
- Zhvillon aftësitë për të menduar dhe argumentuar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.
- Ndjek me vëmendje udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari artistike.

**Kompetenca e të nxënit:**

- Përzgjedh në mënyrë të pavarur mjetet për të realizuar një krijim artistik.
- Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim.
- Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:**

- Drejton dhe merr pjesë aktive në aktivitete të artit pamor si brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.
- Kupton dhe gjen zgjidhje në mënyrë të pavarur për problemet ekologjike, duke u ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

**Kompetenca qytetare:**

- Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.
- Respekton punën e vet dhe të të tjerëve.
- Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

**Kompetenca personale:**

- Krijon besimin te vetja gjatë veprimtarive artistike.
- Merr pjesë në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet.
- Ndërgjegjëson veten dhe zhvillon vetëbesimin dhe krijimin e besimit te të tjerët.

**Kompetenca digjitale**:

- Gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion, si dhe bashkëpunon në rrjete informuese në internet.
- Përdor mjetet të ndryshme në funksion të informacionit artistik si: video *CD, DVD*, aparat fotografik digjital, kamera etj.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:**

- ***Krijimi artistik*:** përdor ide personale, elementet e gjuhës pamore dhe stimuj për krijim; zbulon rrugë të ndryshme të kombinimit të elementeve të artit pamor për të realizuar idetë artistike; përdor hapat e procesit krijues, elementet e artit pamor dhe teknikat artistike; përzgjedh elementet e duhura për të realizuar idetë artistike në tema të personalizuara; përmirëson punën duke u mbështetur te eksperimenti dhe në zgjidhje të ndryshme artistike; analizon burime të ndryshme informacioni dhe qëllimin e tij/saj krijues; identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në krijim, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.
- ***Realizimi i pun*ës*:*** përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë në punë dy dhe tredimensionale në art dhe dizajn; krijon punë origjinale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra ose nëpërmjet kujtesës së tij mbi objektet, njerëzit etj., ose nëpërmjet imagjinatës duke përdorur mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike; vlerëson eksperiencat e tij krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit; zgjedh ide dhe planifikon teknikat dhe mjetet e duhura për realizim; eksperimenton me mjetet shprehëse të mjeteve dhe teknikave të ndryshme artistike për të materializuar idetë e tij/saj; analizon teknika të ndryshme artistike për qëllimin e tij/saj krijues; identifikon elementë të eksperiencës së tij/saj artistike, në lidhje me realizimin e punimit, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.
- ***Vlerësimi artistik*:** analizon dhe interpreton elementet e gjuhës vizuale, organizimin e tyre, teknikën, gjininë në një vepër arti; identifikon dhe vlerëson veprat e artit në aspektin e tyre historik dhe social kulturor; identifikon dhe argumenton aspektin shprehës dhe simbolik të veprës së artit, punës së tij/saj dhe shokut/shoqes duke shprehur emocionet e tij/saj; interpreton, argumenton dhe shpreh këndvështrimin e tij/saj për një vepër arti, objekt artistik, punimin e tij/saj, të shokut/shoqes; përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar veprat e artit, punën e tij/saj, të shokut/shoqes dhe eksperiencën e tij/saj artistike; identifikon elementë të eksperiencës së tij/saj artistike, në vlerësimin e veprave të artit, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur; kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri në periudha të ndryshme historike; identifikon një sërë profesionesh që lidhen me artin pamor dhe me karrierën artistike.

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Gjuha dhe komunikimi artistik | Vija në skulpturë dhe arkitekturë | **Silueta në skulpture dhe në arkitekturë**<br>Mësimi fillon me vëzhgimin e dy imazheve të një skulpture dhe dy imazheve të një ndërtese, të para nga kënde të ndryshme shikimi. Pyetja: Nëse imazhet i përkasin së njëjtës vepër në skulpturë dhe së njëjtës vepër në arkitekturë, atëherë pse ndryshon silueta e tyre?, - nxit nxënësit/et të diskutojnë dhe argumentojnë. Ky diskutim u paraprin edhe njohurive të reja në këtë temë. | Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse<br>Puna në grup dhe puna individuale<br>Hetimi dhe zbulimi<br>Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase<br>Metoda integruese<br>Bashkëbisedim<br>Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues<br>Prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK<br>Projekte kurrikulare | Vlerësim diagnostikues<br>• intervistë me një listë treguesish;<br>• vetëvlerësim me listë kriteresh;<br>Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)<br>• vlerësimi i përgjigjeve me gojë;<br>• vlerësimi i punës në grup;<br>• vlerësim mes nxënësish;<br>• vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;<br>• vlerësimi i detyrave të shtëpisë;<br>• vetëvlerësim;<br>• intervistë me një listë treguesish;<br>• vëzhgim me një listë të plotë treguesish;<br>• portofol;<br>• prezantim me gojë ose me shkrim;<br>• projekt kurrikular. | Teksti i artit pamor për klasën e IX;<br>Materiale nga interneti;<br>Ilustrime veprash arti;<br>Ilustrime të imazheve nga natyra në përshtatje me tema të caktuara;<br>Fotografi të objekteve të artit, dizajnit, artizanatit dhe trashëgimisë kulturore;<br>Slide/ materiale të krijuara nga mësuesit;<br>Modele të detyrave nga nxënësit. |
| 2 | | Format pozitive dhe negative | **Lojë formash**<br>Nxënësit/et vëzhgojnë një imazh të dykuptimtë dhe përpiqen të shquajnë objektin dhe sfondin. Sipas imazhit të dykuptimtë, roli i sfondit dhe i objektit kalon njëherë te njëra e njëherë te tjetra. Kjo lojë figurash ose iluzioni optik i paraprin njohurive të reja mbi format pozitive dhe negative në një vepër arti. | | | |
| 3 | | Skema e ngjyrave monokrom. Kompozimi monokrom | **Tonalitetet e një ngjyre në pikturë**<br>Mbasi vëzhgojnë dy kompozime monokrom në pikturë, nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve: A mund të themi që kompozimet e shfaqura janë njëngjyrëshe? | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | A janë përdorur tonet e çelëta dhe të errëta të një ngjyre në këto piktura? Si formohen tonet e çelëta dhe të errëta të një ngjyre? Ky diskutim u paraprin edhe njohurive të reja në këtë temë. | | | |
| 4 | | Tekstura si mjet shprehës në dizajn | **Karakteristikat e teksturës në objektet e përdorimit të përditshëm** Nëpërmjet një imazhi të njohur familjar, siç mund të jetë ai i një dhome ndenjjeje, nxënësit/et nxiten të diskutojnë për karakteristikat e teksturës së objekteve të ndryshme aty. Ata/ato orientohen të bëjnë lidhjen midis karakteristikës së teksturës dhe funksionit që ka objekti. Në këtë mënyrë, ata/ato parapërgatiten për të marrë njohuritë e reja. | | | |
| 5 | | Vëllimi dhe mënyrat e paraqitjes në pikturë dhe vizatim | **Vëllimi real dhe vëllimi i paraqitur** Nëpërmjet imazheve të ndryshme por edhe nga mjedisi real, nxënësit/et identifikojnë vëllimin real dhe atë të paraqitur në një sipërfaqe dydimensionale. Ata/ato argumentojnë që objektet në mjedis janë ato me vëllime reale dhe në vizatim e pikturë, vëllimi i tyre paraqitet me mjetet dhe teknika të ndryshme. Ky argumentim i paraprin njohurive të reja mbi mënyrat e paraqitjes së vëllimit në sipërfaqen dydimensionale. | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | | Perspektiva me tre pika ikjeje | **Krahasimi midis një kubi me dy paraqitje të ndryshme perspektive** Nxënësit/et vëzhgojnë dy kuba me paraqitje të ndryshme perspektive. Ata/ato përpiqen të gjejnë ndryshimin mes tyre. Pyetje të tilla si: Sa pika ikjeje ka kubi i ndërruar në secilën figurë? A mendoni se kubi me tri pika ikjeje është parë nga lart? – i ndihmojnë ata të zbulojnë më shumë. Ky krahasim i paraprin njohurive të reja mbi perspektivën me tre pika ikjeje. | | | |
| 7 | | Kompozimi. Ekuilibri ose pesha pamore | **Korniza** Me një kornizë të vogël, të thjeshtë prej letre në dorë, çdo nxënës/e përzgjedh një imazh. Mësuesi/ja drejton pyetje të tilla si: A shërben korniza për të zgjedhur imazhin e dëshiruar? A është e ngjashme kjo kornizë me kuadrin e pikturës, vizatimit dhe aparatit fotografik? Ky diskutim i paraprin njohurive të reja mbi ekuilibrin në kuadrin e zgjedhur. | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | | Figura e njeriut | **Figura e njeriut në periudha të ndryshme të historisë së artit** Duke u mbështetur në njohuritë që kanë në historinë e artit, nxënësit/et nxiten të identifikojnë periudhën përkatëse në imazhe që kanë subjekt figurën e njeriut. (Periudha egjiptiane; Periudha antike greke; Periudha e Rilindjes) Në këtë mënyrë, ata/ato shohin qartë mënyrat se si është paraqitur figura e njeriut në periudha të ndryshme duke i paraprirë njohurive të reja. | | | |
| 9 | | Projekt. Figura e njeriut sipas Xhakometit ***Faza e parë:*** **Ndërtimi i skeletit me tel** | **Xhakometi dhe figura e burrit që ecën** Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të vëzhgojnë me kujdes imazhe të skulpturave të Xhakometit dhe të diskutojnë karakteristikat e punës së tij. Duke u mbështetur në këto karakteristika, ata/ato nxiten të realizojnë një figurë duke ndjekur edhe udhëzimet e nevojshme. | | | |
| 10 | | Projekt. Figura e njeriut sipas Xhakometit ***Faza e dytë:*** **Modelimi dhe lëvizja e figurës** | **Personazhe të ndryshme në lëvizje** Mbas fazës së parë, nxënësit/et vëzhgojnë figurina në lëvizje të ndryshme. Ata/ato nxiten të modelojnë me plastelinë me ngjyra ose një ngjyrëshe skeletin e ndërtuar më parë. Gjatë modelimit, ata/ato krijojnë edhe lëvizjen e dëshiruar në figurën e tyre. | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | Teknika dhe procese artistike | Teknika e lapustilave | **Mundësitë shprehëse** të teknikës së lapustilave<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi teknikën e lapustilave dhe mbi mundësitë e shumta shprehëse të kësaj teknike. Nëpërmjet eksperimentit ata/ato zbulojnë mënyra të ndryshme të përdorimit të kësaj teknike dhe zgjedhin një mënyrë për të realizuar krijimin tyre. | | | |
| 12 | | Grafiti urban (ora e parë) | **Mundësitë shprehëse të grafitit urban**<br>Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të vëzhgojnë imazhe të ndryshme të grafitit urban. Mësuesi/ja i pyet nëse ata/ato kanë parë të tilla në vendin ku jetojnë. Pasi diskutojnë për teknikat e realizimit të tyre, mësuesja/si i udhëzon të realizojnë një të tillë, duke u ndarë në grupe, në tabakë të mëdha letre. | | | |
| 13 | | Grafiti urban (ora e dytë) | **Realizimi dhe ekspozimi i grafitit**<br>Pasi kanë realizuar punimet në tabakë letre, mësuesi/ja i fton nxënësit/et të mendojnë për mënyrën e ekspozimit të tyre si një punë e vetme. Çdo grup ideon nga një mënyrë të vendosjes dhe të integrimit të punëve me njëra-tjetrën. | | | |

## 3.3 Planifikimi ditor bazuar në situata të të nxënit (shtator-dhjetor)

### *1. Planifikimi ditor* *data.................................*

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Arte</td><td colspan="2">Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: IX</td></tr>
<tr><td colspan="4">Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>Tema mësimore: Vija në skulpturë dhe arkitekturë</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Silueta në skulpture dhe në arkitekturë<br>Mësimi fillon me vëzhgimin e dy imazheve të një skulpture dhe dy imazheve të një ndërtese të para nga kënde të ndryshme shikimi. Pyetja: “Nëse imazhet i përkasin së njëjtës vepër në skulpturë dhe së njëjtës vepër në arkitekturë, pse ndryshon silueta e tyre? i nxit nxënësit/et të diskutojnë dhe të argumentojnë. Ky diskutim u paraprin edhe njohurive të reja në këtë temë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon dhe reflekton mbi siluetën e objekteve tredimensionale të para nga kënde të ndryshme;<br>- zbulon vijën si mjet shprehës në skulpturë dhe arkitekturë;<br>- përdor mjete të ndryshme artistike për të realizuar cilësinë e dëshiruar të vijës në një krijim tredimensional;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të vijës në krijimet tredimensionale.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- silueta;<br>- vija si mjet shprehës;<br>- vija në skulpturë;<br>- vija në arkitekturë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe të veprave në skulpturë dhe arkitekturë;<br>- materiale si: tel i butë, letër, laps, vizore, gërshërë, ngjitës etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- shkencat e natyrës;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="6" align="center">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="6">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Mësimi fillon me vëzhgimin e dy imazheve të një skulpture dhe dy imazheve të një ndërtese të para nga kënde të ndryshme shikimi. Pyetja: Nëse imazhet i përkasin së njëjtës vepër në skulpturë dhe së njëjtës vepër në arkitekturë, pse ndryshon silueta e tyre?, i nxit nxënësit/et të diskutojnë dhe argumentojnë. Ky diskutim u paraprin edhe njohurive të reja në këtë temë.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Konceptin "Vija si mjet shprehës në skulpturë dhe arkitekturë" mësuesi/ja e shpjegon nëpërmjet imazheve të ndryshme në skulpturë dhe arkitekturë. Edhe në veprat tredimensionale, ashtu si në pikturë dhe në vizatim, vija mund të komunikojë emocione përmes karakteristikave dhe drejtimit të saj. Këto emocione janë të lidhura me eksperiencën tonë trupore në lidhje me drejtimin e vijës. Përdorimi i vijave horizontale, i vijave vertikale, i vijave diagonale, i vijave të harkuara, i vijave spirale, shoqërohet me imazhet përkatëse në skulpturë dhe arkitekturë.<br>Nxënësit/et nxiten të përdorin telin ose shirita letre për të krijuar objekte tredimensionale nëpërmjet përdorimit të vijës. Veprimtaritë në libër shërbejnë si udhëzues për të krijuar një skulpturë me tel sipas Kalder, apo një konstruksion arkitektonik më shirita letre. Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et nxiten të flasin për krijimet e tyre dhe të shokëve/shoqeve. Nëpërmjet vijës nxënësit/et kuptojnë që mund të krijojnë kompozime të larmishme tredimensionale<br>Këto punime ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që nxënësit/et bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

## *2. Planifikimi ditor* *data.................................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>**Tema mësimore**: Format pozitive dhe negative | | **Situata e të nxënit: Lojë formash**<br>Nxënësit/et vëzhgojnë një imazh të dykuptimtë dhe përpiqen të shquajnë objektin dhe sfondin. Sipas imazhit të dykuptimtë, roli i sfondit dhe i objektit kalon njëherë te njëra e njëherë te tjetra. Kjo lojë figurash ose iluzioni optik i paraprin njohurive të reja mbi format pozitive dhe negative në një vepër arti. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon dhe reflekton mbi imazhe për të kuptuar rolin e formave pozitive dhe negative në kompozim;<br>- zbulon marrëdhënien figurë/sfond dhe rëndësinë e saj në kompozim;<br>- përdor mundësitë shprehëse të formave pozitive dhe negative në krijim;<br>- shpreh mendimin e tij/saj mbi marrëdhënien midis formave pozitive dhe negative në krijim. | | **Fjalët kyçe:**<br>- forma pozitive;<br>- forma negative;<br>- marrëdhënia figurë-sfond. | |

| **Burimet/mjetet/materialet:** | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:** |
|---|---|
| - teksti i nxënësit;<br>- imazhe fotografike, imazhe të dykuptimta (iluzion optik), imazhe të veprave të artit;<br>- materiale si: lapsa, letra vizatimi, lapsa me ngjyra ose lapustila, letër të zezë, gërshërë, ngjitës etj. | ***Lidhje me fushat kurrikulare*:**<br>-shkencat e natyrës;<br>-gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare*:**<br>- mjedisi. |

| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nxënësit/et vëzhgojnë një imazh të dykuptimtë dhe përpiqen të shquajnë objektin dhe sfondin. Sipas imazhit të dykuptimtë, roli i sfondit dhe i objektit kalon njëherë te njëra e njëherë te tjetra. Kjo lojë figurash ose iluzioni optik i paraprin njohurive të reja mbi format pozitive dhe negative në një vepër arti. |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Nëpërmjet imazheve të ndryshme ose shembujve nga mjedisi nxënësit/et zbulojnë format pozitive dhe negative.<br>Nëpërmjet veprave të artit ata/ato zbulojnë që marrëdhënia figurë sfond, është pikërisht loja që krijojnë format (ose hapësirat) pozitive dhe negative në kompozim. Në vepra të ndryshme, ato krijojnë edhe marrëdhënie të ndryshme.<br>Veprimtaritë në libër shërbejnë si udhëzues për t'u shprehur nëpërmjet formave pozitive dhe negative. Nxënësit/et mund të zgjedhin të krijojnë një imazh të dykuptimtë sipas Esher ose sipas traditës japoneze "Notan". Në këtë mënyrë, nxënësit/et zbulojnë mundësitë shprehëse të formave pozitive dhe negative në krijim dhe marrëdhënien që krijojnë mes tyre.<br>Këto punime ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që nxënësit/et bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

***3. Planifikimi ditor*** ***data...................................***

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa:** IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>**Tema mësimore**: Skema e ngjyrave monokrom. Kompozimi monokrom | | **Situata e të nxënit: Tonalitetet e një ngjyre në pikturë**<br>Mbasi vëzhgojnë dy kompozime monokrom në pikturë, nxënësit/et i përgjigjen pyetjes: A mund të themi që kompozimet e shfaqura janë njëngjyrëshe? A janë përdorur tonet e çelëta dhe të errëta të një ngjyre në këto piktura? Si formohen tonet e çelëta dhe të errëta të një ngjyre? Ky diskutim u paraprin edhe njohurive të reja në këtë temë. | |

<table>
<tr>
<td>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon kompozime monokrom dhe diskuton mbi mënyrën e përdorimit të një ngjyre në to;<br>- zbulon skemën monokrom të ngjyrave dhe kompozimin monokrom;<br>- përdor skemën monokrom të ngjyrave në krijim.<br>- shpreh mendimin e tij/saj për karakteristikat e kompozimit monokrom.</td>
<td>Fjalët kyçe:<br>- skema e ngjyrave monokrom;<br>- kompozimi monokrom.</td>
</tr>
<tr>
<td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- skema monokrom e ngjyrave;<br>- imazhe të ndryshme me kompozime monokrom;<br>- materiale të tilla, si: letër, laps, tempera, penel, gotë me ujë.</td>
<td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- shkencat e natyrës;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- mjedisi.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2" align="center">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Mbasi vëzhgojnë dy kompozime monokrom në pikturë, nxënësit/et i përgjigjen pyetjes: A mund të themi që kompozimet e shfaqura janë njëngjyrëshe? A janë përdorur tonet e çelëta dhe të errëta të një ngjyre në këto piktura? Si formohen tonet e çelëta dhe të errëta të një ngjyre? Ky diskutim u paraprin edhe njohurive të reja në këtë temë.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Nëpërmjet skemës monokrom të ngjyrave nxënësit/et zbulojnë përbërësit e saj (ngjyrën bazë, tonet e errëta të ngjyrës dhe tonet e çelëta të ngjyrës). Imazhet fotografike dhe të disa pikturave ilustrojnë konceptin e kompozimit monokrom (kompozimit njëngjyrësh).<br>Veprimtaritë në libër shërbejnë si udhëzues për t'u shprehur nëpërmjet përdorimit të tonaliteteve të një ngjyre, pra kompozimit monokrom. Nxënësit/et mund të zgjedhin të krijojnë një dekoracion monokrom ose një pikturë monokrom.<br>Pasi mbarojnë, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Vlerësimi i nxënësit<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve.</td>
</tr>
</table>

## 4. Planifikimi ditor data..................................

<table>
<tr><td>Fusha: Arte</td><td>Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: IX</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>Tema mësimore: Tekstura si mjet shprehës në dizajn</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Karakteristikat e teksturës në objektet e përdorimit të përditshëm<br>Nëpërmjet një imazhi të njohur familjar, siç mund të jetë ai i një dhome ndenjjeje, nxënësit/et nxiten të diskutojnë për karakteristikat e teksturës së objekteve të ndryshme aty. Ata/ato orientohen të bëjnë lidhjen midis karakteristikës së teksturës dhe funksionit që ka objekti. Në këtë mënyrë, ata parapërgatiten për të marrë njohuritë e reja.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon me vëmendje paraqitjen e teksturës në objekte të përdorimit të përditshëm;<br>- reflekton mbi karakteristikat e teksturës së objekteve dhe funksionit të tyre;<br>- zbulon tri funksionet e teksturës në objektet e dizajnit;<br>- krijon teksturën e objekteve për qëllim dekorativ, teknik dhe komunikues;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për rëndësinë e teksturës në përmbushjen e funksionit të objekteve në dizajn.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- tekstura në dizajn;<br>- funksioni komunikues i teksturës;<br>- funksioni dekorativ i teksturës;<br>- funksioni teknik i teksturës.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe që tregojnë objekte të përdorimit të përditshëm me tekstura të ndryshme;<br>- materiale të ndryshme të ricikluеshme, ngjitëse etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- shkencat e natyrës;<br>- teknologjia;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Nëpërmjet një imazhi të njohur familjar, siç mund të jetë ai i një dhome ndenjjeje, nxënësit/et nxiten të diskutojnë për karakteristikat e teksturës së objekteve të ndryshme aty. Ata/ato orientohen të bëjnë lidhjen midis karakteristikës së teksturës dhe funksionit që ka objekti. Në këtë mënyrë, ata/ato parapërgatiten për të marrë njohuritë e reja.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Mësuesi/ja shpjegon se tekstura në objektet e dizajnit shpesh ka disa funksione, prandaj ndonjëherë është e vështirë t'i ndash ato nga njëra-tjetra.<br>Ndër funksionet e teksturës do të veçonim tri kryesoret: funksionin komunikues, funksionin dekorativ dhe atë teknik. Imazhet e ndryshme ndihmojnë nxënësit/et të zbulojnë funksionet e teksturës në objektet e dizajnit.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| Veprimtaritë në libër shërbejnë si udhëzues për të krijuar teksturën e objekteve me qëllim dekorativ, teknik dhe komunikues. Ata/ato zgjedhin të krijojnë një objekt me teksturë për një qëllim të caktuar. Pasi mbarojnë punën, ata/ato diskutojnë mbi mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Nxënësit/et kuptojnë rëndësinë e teksturës në objektet e dizajnit.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e:<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës:<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

## *5. Planifikimi ditor* *data.................................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>**Tema mësimore**: Vëllimi dhe mënyrat e paraqitjes në pikturë dhe vizatim | | **Situata e të nxënit: Vëllimi real dhe vëllimi i paraqitur**<br>Nëpërmjet imazheve të ndryshme por edhe nga mjedisi real, nxënësit/et identifikojnë vëllimin real dhe atë të paraqitur në një sipërfaqe dydimensionale. Ata/ato argumentojnë që objektet në mjedis janë ato me vëllime reale dhe në vizatim dhe pikturë, vëllimi i tyre paraqitet me mjetet dhe teknika të ndryshme. Ky argumentim i paraprin njohurive të reja mbi mënyrat e paraqitjes së vëllimit në sipërfaqen dydimensionale. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon imazhe dhe diskuton mbi vëllimin real të objekteve dhe vëllimin e paraqitur mbi sipërfaqen dydimensionale;<br>- reflekton mbi karakteristikat tredimensionale të vëllimit real të objekteve;<br>- zbulon metodat e paraqitjes së vëllimit mbi sipërfaqen dydimensionale;<br>- përdor metodat e duhura të paraqitjes së vëllimit mbi sipërfaqen dydimensionale;<br>- vlerëson punën e tij dhe të shokëve. | | **Fjalët kyçe:**<br>- vëllimi real;<br>- vëllimi i paraqitur;<br>- metodat e paraqitjes së vëllimit. | |

| **Burimet/mjetet/materialet:** | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.** |
|---|---|
| - teksti i nxënësit;<br>- fotografi që tregojnë objekte me vëllim real dhe me vëllim të paraqitur;<br>- materiale të tilla, si: letër, laps, lapustila etj. | ***Lidhje me fushat kurrikulare*:**<br>- shkencat e natyrës;<br>- teknologjia;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare*:**<br>mjedisi. |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nëpërmjet imazheve të ndryshme por edhe nga mjedisi real, nxënësit/et identifikojnë vëllimin real dhe atë të paraqitur në një sipërfaqe dydimensionale. Ata/ato argumentojnë që objektet në mjedis janë ato me vëllime reale dhe në vizatim dhe pikturë, vëllimi i tyre paraqitet me mjetet dhe teknika të ndryshme. Ky argumentim i paraprin njohurive të reja mbi mënyrat e paraqitjes së vëllimit në sipërfaqen dydimensionale. | |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Nxënësit/et reflektojnë mbi natyrën tredimensionale të vëllimit real të objekteve nëpërmjet imazheve të ndryshme. Nëpërmjet imazheve në vizatim dhe pikturë ata/ato zbulojnë metodat e paraqitjes së vëllimit të objekteve në to (nëpërmjet dritë-hijes dhe perspektivës).<br>Veprimtaritë në libër shërbejnë si udhëzues për të përdorur teknikat e paraqitjes së vëllimit në vizatim. Në krijimet e tyre, nxënësit/et i kthejnë format e sheshta në forma tredimensionale.<br>Në fund të detyrës, nxënësit/et flasin për punën e tyre, për mënyrën e realizimit dhe për vështirësitë që hasën. Ata/ato shpjegojnë cilën metodë përdorën për të krijuar vëllimin në punët e tyre.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. | |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. | |

## *6. Planifikimi ditor* *data.................................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>**Tema mësimore**: Perspektiva me tri pika ikjeje | | **Situata e të nxënit: Krahasimi midis një kubi me dy paraqitje të ndryshme perspektive**<br>Nxënësit/et vëzhgojnë dy kuba me paraqitje të ndryshme perspektive. Ata/ato përpiqen të gjejnë ndryshimin mes tyre. Pyetje të tilla si: Sa pika ikjeje ka kubi i ndërruar në secilën figurë? A mendoni se kubi me tri pika ikjeje është parë nga lart? – i ndihmojnë ata të zbulojnë më shumë. Ky krahasim i paraprin njohurive të reja mbi perspektivën me tri pika ikjeje. | |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- Vëzhgon, me qëllim për të identifikuar mënyrën e paraqitjes së objektit në perspektivë;<br>- reflekton mbi mënyrën e paraqitjes së objektit nëpërmjet perspektivës me tre pika;<br>- zbulon tiparet dalluese të perspektivës me tri pika ikjeje dhe mënyrën se si paraqitet në sipërfaqen dydimensionale;<br>- përdor qëllimisht mënyrat e paraqitjes të perspektivës me tri pika për të arritur rezultatin e dëshiruar;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mënyrat e paraqitjes së hapësirës në krijim. | **Fjalët kyçe:**<br>- hapësira;<br>- perspektiva me tri pika ikjeje;<br>- pika e shikimit nga lartë (sytë e zogut);<br>- pika e shikimit nga poshtë (sytë e milingonës). |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe që ilustrojnë perspektivën me tri pika ikjeje;<br>- mjete të tilla, si: laps, letër, vizore, lapsa me ngjyra. | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare*:**<br>- shkencat e natyrës;<br>- matematika;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare*:**<br>- mjedisi. |

**Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve**

***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***

Nxënësit/et vëzhgojnë dy kuba me paraqitje të ndryshme perspektive. Ata/ato përpiqen të gjejnë ndryshimin mes tyre. Pyetje të tilla si: Sa pika ikjeje ka kubi i ndërruar në secilën figurë? A mendoni se kubi me tri pika ikjeje është parë nga lart? – i ndihmojnë ata të zbulojnë më shumë. Ky krahasim i paraprin njohurive të reja mbi perspektivën me tri pika ikjeje.

***Ndërtimi i njohurive të reja***

Nëpërmjet imazheve me ndërtesa të larta, nxënësit/et zbulojnë pikat e shikimit. Pyetjes: Si i vizatojnë artistët ndërtesat e para nga lart? Po ato të para nga poshtë? – ja jep përgjigjen perspektiva me tri pika ikjeje. Nëpërmjet imazheve të filmave vizatimorë nxënësit/et zbulojnë mënyrën e përdorimit të perspektivës me tre pika dhe shtrembërimet që sjell ajo nga artistët. Duke qenë një metodë me rregulla të sakta, nxënësit/et është mirë të ndjekin udhëzimet e mësuesit/es për të realizuar një ndërtesë me tri pika ikjeje. Ata/ato zgjedhin pikën e shikimit sipas dëshirës.

Pasi mbarojnë detyrën, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën.

Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

***Vlerësimi i nxënësit***

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve.

## *7. Planifikimi ditor* *data.................................*

<table>
<tr><td>Fusha: Arte</td><td>Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: IX</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>Tema mësimore: Kompozimi.<br>Ekuilibri ose pesha pamore</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Korniza<br>Me një kornizë të vogël e të thjeshte prej letre, në dorë, çdo nxënës/e përzgjedh një imazh. Mësuesi/ja drejton pyetje të tilla si: A shërben korniza për të zgjedhur imazhin e dëshiruar? A është e ngjashme kjo kornizë me kuadrin e pikturës, vizatimit dhe aparatit fotografik? Ky diskutim i paraprin njohurive të reja mbi ekuilibrin në kuadrin e zgjedhur.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon përmes kornizës së improvizuar, me qëllim për të përzgjedhur imazhin e dëshiruar;<br>- reflekton mbi mënyrën e përzgjedhjes së elementeve brenda kornizës së kompozimit;<br>- zbulon mënyrat e krijimit të ekuilibrit (peshës pamore) në një vepër arti;<br>- krijon një kompozim të ekuilibruar;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për rëndësinë e ekuilibrit në krijim.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- korniza;<br>- kompozimi;<br>- ekuilibri ose pesha pamore.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe që ilustrojnë kornizën, konceptin e peshës pamore; vepra arti;<br>- materiale të tilla, si: laps, letër, lapsa me ngjyra ose lapustila, revista, letra me ngjyra, gërshërë, ngjitës etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- shkencat e natyrës;<br>- matematika;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>mjedisi;<br>njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Me një kornizë të vogël e të thjeshte prej letre, në dorë, çdo nxënës/e përzgjedh një imazh. Mësuesi/ja drejton pyetje të tilla si: A shërben korniza për të zgjedhur imazhin e dëshiruar? A është e ngjashme kjo kornizë me kuadrin e pikturës, vizatimit dhe aparatit fotografik? Ky diskutim i paraprin njohurive të reja mbi ekuilibrin në kuadrin e zgjedhur.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Nëpërmjet kompozimeve të ndryshme të një imazhi nxënësit/et, reflektojnë se kompozimi është formati apo hapësira ku artisti apo fotografi vendosin së bashku elementet e imazhit.</td></tr>
</table>

Për të kuptuar që këta elemente përbërëse të këtij imazhi duhet të jenë të ekuilibruara, krahasimi i peshës pamore me peshën fizike është një strategji e përshtatshme. Vepra të ndryshme të artit janë një shembull i mirë për të kuptuar se si është realizuar ekuilibri në to. Veprimtaria në libër orienton nxënësit/et të rikompozojnë një personazh të marrë nga një vepër arti, por edhe nga ndonjë imazh fotografik. Nëpërmjet elementeve që ata/ato vendosin, krijojnë ekuilibrin me figurën e personazhit.
Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit të ekuilibrit dhe vështirësitë që hasën.
Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

***Vlerësimi i nxënësit***

Ky vlerësim do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve.

## *8. Planifikimi ditor* *data...................................*

<table>
<tr><td>Fusha: Arte</td><td>Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: IX</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>Tema mësimore: Figura e njeriut</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Figura e njeriut në periudha të ndryshme të historisë së artit<br>Duke u mbështetur në njohuritë që kanë në historinë e artit, nxënësit/et nxiten të identifikojnë periudhën përkatëse në imazhe që kanë subjekt figurën e njeriut. (Periudha egjiptiane; Periudha antike greke; Periudha e Rilindjes) Në këtë mënyrë ata/ato shohin qartë mënyrat sesi është paraqitur figura e njeriut në periudha të ndryshme duke i paraprirë njohurive të reja.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon dhe reflekton mbi mënyrën e paraqitjes së figurës së njeriut në periudha të ndryshme të historisë së artit;<br>- zbulon raportet proporcionale të ndërtimit të trupit të njeriut në periudha të ndryshme të historisë së artit;<br>- vizaton trupin e njeriut në lëvizje sipas modeleve në manekin;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mënyrat e realizimit të lëvizjes në figurën e njeriut.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- figura e njeriut;<br>- përmasat e trupit;<br>- kanuni i proporcioneve;<br>- figura në lëvizje.</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe që ilustrojnë përmasat e trupit të njeriut në periudha të ndryshme;<br>- materiale të tilla, si: laps, letër, gomë, manekin.</td><td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- shkencat e natyrës;<br>- matematika;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>mjedisi;<br>njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Duke u mbështetur në njohuritë që kanë në historinë e artit, nxënësit/et nxiten të identifikojnë periudhën përkatëse në imazhe që kanë subjekt figurën e njeriut. (Periudha egjiptiane; Periudha antike greke; Periudha e Rilindjes) Në këtë mënyrë, ata/ato shohin qartë mënyrat se si është paraqitur figura e njeriut në periudha të ndryshme, duke i paraprirë njohurive të reja.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Nëpërmjet imazheve, nxënësit/et reflektojnë se që nga antikiteti, artistët, duke dashur të pasqyrojnë trupin e njeriut në veprat e tyre, kanë studiuar raportet që kanë përmasat e pjesëve të ndryshme të trupit me njëra-tjetrën. Ata/ato njihen me përmasat e trupit të njeriut në artin egjiptian, në periudhën e antikitetit dhe të rilindjes. Ndryshimi i përmasave te trupi i njeriut përgjatë rritjes dhe paraqitja e figurës në lëvizje janë pjesë e njohurive të reja.<br>Veprimtaritë në libër orientojnë nxënësit/et si të vizatojnë trupin e njeriut në lëvizje me ndihmën e manekinit (manekini mund të jetë tredimensional, por mund të krijohet edhe vetë me karton, sipas shembullit në libër).<br>Pasi mbarojnë vizatimin, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit të lëvizjeve në figurën që realizuan.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Vlerësimi i nxënësit<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve.</td></tr>
</table>

## *9. Planifikimi ditor* *data....................................*

<table>
<tr><td>Fusha: Arte</td><td>Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: IX</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik<br>Tema mësimore: Projekt. Figura e njeriut sipas Xhakometit<br>Faza e parë: Ndërtimi i skeletit me tel</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Xhakometi dhe figura e burrit që ecën<br>Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të vëzhgojnë me kujdes imazhe të skulpturave të Xhakometit dhe të diskutojnë karakteristikat e punës së tij. Këto skulptura të holla paraqesin figurën e njeriut dhe natyrshmërinë e lëvizjeve, pa përdorimin e vëllimit të muskulaturës.</td></tr>
</table>

| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon karakteristikat e paraqitjes së figurës së njeriut në skulpturën e Xhakometit;<br>- zbulon mënyrën e realizimit të figurës, duke u mbështetur te vepra e Xhakometit;<br>- realizon skeletin me tel të figurinës;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për karakteristikat e skulpturës së Xhakometit; | **Fjalët kyçe:**<br>- figura sipas Xhakometit;<br>- karakteristikat e paraqitjes së figurës;<br>- skeleti prej teli. |
|---|---|
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe që ilustrojnë hënën dhe diellin të personifikuara në portrete njerëzore gjatë kohërave të ndryshme;<br>- materiale të tilla, si: laps, letër, gomë. | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare:***<br>- shkencat e natyrës;<br>- matematika;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>mjedisi;<br>njohja e kulturave. |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të vëzhgojnë me kujdes imazhe të skulpturave të Xhakometit dhe të diskutojnë karakteristikat e punës së tij. Këto skulptura të holla paraqesin figurën e njeriut dhe natyrshmërinë e lëvizjeve, pa përdorimin e vëllimit të muskulaturës. | |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Duke u mbështetur në këto karakteristika, ata/ato nxiten të realizojnë një figurë duke ndjekur edhe udhëzimet e nevojshme. Figura realizohet me tel dhe mbështillet me letër ngjitëse në fazën e parë.<br>Pasi mbarojnë fazën e parë, nxënësit/et flasin për punën e tyre dhe për mënyrën e realizimit të figurinës. | |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e:<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. | |

## *10. Planifikimi ditor* *data....................................*

<table>
<tr><td>Fusha: Arte</td><td>Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: IX</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>Tema mësimore: Projekt. Figura e njeriut sipas Xhakometit<br>Faza e dytë: Modelimi dhe lëvizja e figurës</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Personazhe të ndryshme në lëvizje<br>Mbas fazës së parë nxënësit vëzhgojnë figurina të ndryshme në lëvizje, dhe diskutojnë për karakteristikat e veçanta që ato marrin nëpërmjet lëvizjes.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon imazhe me figurina të ndryshme në lëvizje;<br>- zbulon se lëvizja është e lidhur me karakteristikat e figurës (në lidhje me profesionin, veshjen, format etj.);<br>- modelon dhe krijon lëvizjen e figurës;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për karakteristikat shprehëse të figurinës së krijuar.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- modelimi;<br>- lëvizja;<br>- karakteristikat e shprehëse të personazhit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe të figurave të ndryshme në lëvizje sipas karakteristikave shprehëse;<br>- materiale të tilla, si: plastelina me ngjyra ose letër me vinovil.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- shkencat e natyrës;<br>- matematika;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>mjedisi;<br>njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Mbas fazës së parë, nxënësit/et vëzhgojnë figurina të ndryshme në lëvizje, dhe diskutojnë për karakteristikat e veçanta që ato marrin nëpërmjet lëvizjes.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Ata/ato nxiten të modelojnë me plastelinë me ngjyra ose një ngjyrëshe skeletin e ndërtuar më parë. Gjatë modelimit, nxënësit/et krijojnë edhe lëvizjen e dëshiruar në figurën e tyre. Poza që ata zgjedhin, karakterizon edhe personazhin e tyre (për modelimin nxënësit/et mund të përdorin plastelinën me ngjyra ose teknikën e letrës së lagur).<br>Pasi modelojnë figurinën, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit të saj dhe lëvizjes që përcakton edhe personazhin.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</td></tr>
</table>

| ***Vlerësimi i nxënësit*** |
|---|
| Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

## *11. Planifikimi ditor* *data...................................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Teknika e lapustilave | | **Situata e të nxënit: Mundësitë shprehëse** të teknikës së lapustilave<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi teknikën e lapustilave dhe mbi mundësitë e shumta shprehëse të kësaj teknike. Nëpërmjet eksperimentit, ata/ato zbulojnë mënyra të ndryshme të përdorimit të kësaj teknike dhe zgjedhin një mënyrë për të realizuar krijimin tyre. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së lapustilave;<br>- përdor me kompetencë teknikën e lapustilave në krijim;<br>- eksperimenton me lapustilat, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së lapustilave. | | **Fjalët kyçe:**<br>- lapustila;<br>- majat e lapustilave. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të vizatimeve me teknikën e lapustilave;<br>- mjete të tilla, si: laps, letër, gomë, lapustila. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. | |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | | | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi teknikën e lapustilave dhe mbi mundësitë e shumta shprehëse të kësaj teknike. Nëpërmjet eksperimentit, ata/ato zbulojnë mënyra të ndryshme të përdorimit të kësaj teknike dhe zgjedhin një mënyrë për të realizuar krijimin tyre. | | | |

| |
|---|
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja nëpërmjet lapustilave me maja të ndryshme demonstron dhe shpjegon se përzgjedhja e majës së duhur është mjaft e rëndësishme për të arritur rezultatin e dëshiruar në krijim. Mësuesi/ja shpjegon mënyrat e përdorimit dhe mundësitë shprehëse të teknikës së lapustilave. Veprimtaria i udhëzon nxënësit/et të ndjekin hapat për realizimin e vizatimit nëpërmjet kësaj teknike. Nxënësit/et zgjedhin të përdorin një nga mënyrat shprehëse të lapustilave (pikëzimin, vijëzimin ose efektin e mozaikut). Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të tij. Ata/ato kuptojnë mundësitë e shumta shprehëse të kësaj teknike.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

## *12. Planifikimi ditor* *data...................................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Grafiti urban (ora e parë) | | **Situata e të nxënit: Mundësitë shprehëse të grafitit urban**<br>Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të vëzhgojnë imazhe të ndryshme të grafitit urban. Mësuesi/ja i pyet nëse ata/ato kanë parë të tilla në vendin ku ata jetojnë. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të grafitit urban;<br>- përdor me kompetencë elementet e gjuhës artistike dhe teknikat artistike për të realizuar një murale në letër;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së grafitit urban. | | **Fjalët kyçe:**<br>- grafiti urban;<br>- mjete dhe teknika të përshtatshme për grafitin urban (stensil, bombula spraji, penela). | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe të grafiteve urbane;<br>- mjete të tilla, si: laps, tabake letër, akrilikë ose tempera, penela etj. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. | |

| Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të vëzhgojnë imazhe të ndryshme të grafitit urban. Mësuesi/ja i pyet nëse ata kanë parë të tilla në vendin ku jetojnë. |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Pasi diskutojnë për teknikat e realizimit të tyre, mësuesi/ja i udhëzon ata/ato të realizojnë një të tillë në tabakë të mëdha letre, duke u ndarë në grupe, Artisti Keith Hering është një shembull i mirë për t'u mbështetur në krijimin e një muraleje në letër. Karakteristikat e punës së tij janë një udhëzues i mirë për nxënësit/et. Në këtë rast, bashkëpunimi mes tyre është i nevojshëm dhe pjesë e punës në grup.<br>Në fund të orës, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të saj. Ata/ato kuptojnë mundësitë e shumta shprehëse në realizimin e muraleve me letër. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

## *13. Planifikimi ditor* *data..................................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Grafiti urban (ora e dytë) | | **Situata e të nxënit: Realizimi dhe ekspozimi i grafitit**<br>Pasi kanë realizuar punimet në tabakë letre, mësuesi/ja i fton nxënësit/et të mendojnë për mënyrën e ekspozimit të tyre si një punë e vetme. Çdo grup ideon nga një mënyrë të vendosjes dhe të integrimit të punëve me njëra-tjetrën. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të grafitit urban;<br>- realizon ekspozimin e grafiteve, duke i integruar si një punë e vetme;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së grafitit urban dhe mënyrat e ekspozimit. | | **Fjalët kyçe:**<br>- grafiti urban;<br>- mjete dhe teknika të përshtatshme për grafitin urban (stensil, bombula spraji, penela). | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- punimet e realizuara ne letër;<br>- mjete për vendosjen e punimeve në mur. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia. | |

| | |
|---|---|
| | ***Lidhja me temat ndërkurrikulare*:**<br>- njohja e kulturave. |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Pasi kanë realizuar punimet në tabakë letre, mësuesi/ja i fton nxënësit/et të mendojnë për mënyrën e ekspozimit të tyre si një punë e vetme. Çdo grup ideon nga një mënyrë të vendosjes dhe të integrimit të punëve me njëra-tjetrën. | |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Më pas, nxënësit/et i ekspozojnë punimet e integruara me njëra-tjetrën në muret e klasës apo korridoret e shkollës si një murale. Edhe në këtë rast, bashkëpunimi mes tyre është i nevojshëm për realizimin me sukses të murales.<br>Në fund të orës, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të murales. Ata/ato kuptojnë mundësitë e shumta shprehëse në realizimin e muraleve, si me letër ashtu edhe direkt në mur. | |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. | |

## 3. 4. PLANIFIKIMI TEMATIK PËR 3 MUJORIN Ë DYTË JANAR – MARS

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**

**Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:**

- Zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike.
- Gjykon drejt mesazhet, që u adresohet.
- Shprehet qartë dhe saktë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale.
- Komunikon qartë mendimin e tij/saj.
- Shfrytëzon në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese, mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme.

**Kompetenca e të menduarit:**

- Përpunon njohuritë vizuale në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi.
- Zgjidh në mënyrë të pavarur probleme të ndryshme artistike.
- Zhvillon aftësitë për të menduar dhe argumentuar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.
- Ndjek me vëmendje udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari artistike.

**Kompetenca e të nxënit:**

- Përzgjedh në mënyrë të pavarur mjetet për të realizuar një krijim artistik.
- Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim.
- Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:**

- Drejton dhe merr pjesë aktive në aktivitete të artit pamor si brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.
- Kupton dhe gjen zgjidhje në mënyrë të pavarur për problemet ekologjike, duke u ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

**Kompetenca qytetare:**

- Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.
- Respekton punën e vet dhe të të tjerëve.
- Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

**Kompetenca personale:**

- Krijon besimin te vetja gjatë veprimtarive artistike.
- Merr pjesë në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet.

Ndërgjegjëson veten dhe zhvillon vetëbesimin dhe krijimin e besimit te të tjerët.**Kompetenca digjitale**:

- Gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet.
- Përdor mjetet të ndryshme në funksion të informacionit artistik si: video, *CD, DVD*, aparat fotografik digjital, kamera etj.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:**

- ***Krijimi artistik*:** përdor ide personale, elementet e gjuhës pamore dhe stimuj për krijim; zbulon rrugë të ndryshme të kombinimit të elementeve të artit pamor për të realizuar idetë artistike; përdor hapat e procesit krijues, elementet e artit pamor dhe teknikat artistike; përzgjedh elementet e duhura për të realizuar idetë artistike në tema të personalizuara; përmirëson punën duke u mbështetur tek eksperimenti dhe në zgjidhje të ndryshme artistike; analizon burime të ndryshme informacioni dhe qëllimin e tij/saj krijues; identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në krijim, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.
- ***Realizimi i pun*ës*:*** përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë në punë dy dhe tredimensionale në art dhe dizajn; krijon punë origjinale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra ose nëpërmjet kujtesës së tij mbi objektet njerëzit etj., ose nëpërmjet imagjinatës duke përdorur mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike; vlerëson eksperiencat e tij krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit; zgjedh ide dhe planifikon teknikat dhe mjetet e duhura për realizim; eksperimenton me mjetet shprehëse të mjeteve dhe teknikave të ndryshme artistike për të materializuar idetë e tij/saj; analizon teknika të ndryshme artistike për qëllimin e tij/saj krijues; identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në lidhje me realizimin e punimit, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.
- ***Vlerësimi artistik*:** analizon dhe interpreton elementet e gjuhës vizuale, organizimin e tyre, teknikën, gjininë në një vepër arti; identifikon dhe vlerëson veprat e artit në aspektin e tyre historik dhe social kulturor; identifikon dhe argumenton aspektin shprehës dhe simbolik të veprës së artit, punës së tij/saj dhe shokut/shoqes duke shprehur emocionet e tij/saj; interpreton, argumenton dhe shpreh këndvështrimin e tij/saj për një vepër arti, objekt artistik, punimin e tij/saj, të shokut/shoqes; përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar veprat e artit, punën e tij/saj, të shokut/shoqes dhe eksperiencën e tij/saj artistike; identifikon elementë të eksperiencës së tij/saj artistike, në vlerësimin e veprave të artit, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur; kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri në periudha të ndryshme historike; identifikon një sërë profesionesh që lidhen me artin pamor dhe me karrierën artistike.

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | | Teknika stampimi dekorative | **Teknikat e stampimit dhe mënyrat e përdorimit**<br>Nëpërmjet imazheve me teknika stampimi të ndryshme dekorative mësuesi/ja i fton nxënësit/et t'i kujtojnë ato, duke shpjeguar edhe karakteristikat e tyre, me të cilat ata/ato janë njohur më parë. Të tilla, si: *Stampa me reliev*, *stampa me gdhendje* apo *stampa me letër*. | Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse<br><br>Puna në grup dhe puna individuale<br><br>Hetimi dhe zbulimi<br><br>Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase<br><br>Metoda integruese<br><br>Bashkëbisedim<br><br>Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues<br><br>Prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK<br><br>Projekte kurrikulare | Vlerësim diagnostikues<br>• intervistë me një listë treguesish;<br>• vetëvlerësim me listë kriteresh;<br><br>Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)<br>• vlerësimi i përgjigjeve me gojë;<br>• vlerësimi i punës në grup;<br>• vlerësim mes nxënësish;<br>• vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;<br>• vlerësimi i detyrave të shtëpisë;<br>• vetëvlerësim;<br>• intervistë me një listë treguesish;<br>• vëzhgim me një listë të plotë treguesish;<br>• portofol;<br>• prezantim me gojë ose me shkrim;<br>• planifikimi kurrikular. | Teksti i artit pamor për klasën e IX<br><br>Materiale nga interneti<br><br>Ilustrime veprash arti<br><br>Ilustrime të imazheve nga natyra në përshtatje me tema të caktuara<br><br>Fotografi të objekteve të artit, dizajnit, artizanatit dhe trashëgimisë kulturore<br><br>Slide/ materiale të krijuara nga mësuesit<br><br>Modele të detyrave nga nxënësit |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 | | Fotografia dhe fotokolazhi | **Fotokolazhi**<br>Në imazhin e një fotokolazhi nxënësit/et zbulojnë elementet që e përbëjnë atë. Duke e krahasuar me një imazh fotografik ta/ato kuptojnë ndryshimin midis fotokolazhit dhe fotografisë. Nxënësit/et theksojnë karakteristikën e fotografisë "paraqitjen besnike të realitetit" dhe atë të fotokolazhit i cili përbëhet nga një kolazh me fotografi. | | | |
| 16 | | Dizajni i tekstileve | **Llojet e dizajnit të tekstileve**<br>Nëpërmjet shembujve (në imazhe apo shembuj real), nxënësit/et përfshihen në identifikimin e teknikave të ndryshme të dizajnit të tekstileve. Ata/ato identifikojnë endjen, qëndisjen, trikotazhin, ngjyrosjen dhe stampimin si teknika të dizajnit të tekstileve. | | | |
| 17 | | Dizajni i modës | **Dizajni i modës dhe funksioni i veshjes**<br>Nxënësit/et ftohen të diskutojnë mbi modën dhe mënyrën se si u pëlqen të vishen. Ata/ato diskutojnë mbi funksionet e veshjes dhe rëndësinë që ajo ka në mënyrën e prezantimit të njeriut në shoqëri. | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 18 | | Skulptura. Modelimi | **Modelimi me materiale të ndryshme** Nxënësit/et diskutojnë mbi teknikën e modelimit dhe karakteristikat e saj. Ata/ato diskutojnë për materialet e ndryshme që përdoren në teknikën e modelimit si: plastelinë, letër të lagur, tel apo edhe tekstile. | | | |
| 19 | | Skulptura. Modelimi | **Modelimi i figurës mbi armaturë** Nxënësit/et diskutojnë për karakteristikat e modelimit në skulpturë të artistes (së marrë si referim) dhe si do të pasqyrohet kjo në punën e tyre. Nxënësit/et përmes imazheve identifikojnë që, karakteristikë e veprave të artistes, përveç formës, është edhe përdorimi i ngjyrave të pastra. | | | |
| 20 | | Skulptura. Gdhendja | **Gdhendja mbi materiale të ndryshme** Nxënësit/et diskutojnë mbi njohuritë në teknikën e gdhendjes, mjetet dhe materialet që përdoren. Nëpërmjet imazheve ata/ato identifikojnë gdhendjen e materialeve të ndryshme si atë të gurit, drurit, akullit, frutave, (për arsye dekorative). | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 | | Derdhja | **Derdhja. Forma pozitive dhe forma negative**<br>Duke vëzhguar imazhin e një kallëpi të një objekti dhe objektin, nxënësit/et identifikojnë formën negative dhe pozitive në procesin e derdhjes. Gjithashtu ata/ato identifikojnë kallëpin një pjesësh për relievin dhe dy pjesësh për skulpturën e rrumbullakët. Ata/ato sjellin shembuj të ndryshëm nga riprodhimi i objekteve në industri. | | | |
| 22. | | Konstruksioni. Skenografia e teatrit | **Shumëllojshmëria e skenografisë së teatrit**<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi eksperiencat e tyre në teatër, apo njohuritë që kanë mbi teatrin. Ata/ato identifikojnë hapësirat që përbëjnë teatrin dhe shumëllojshmërinë e skenografisë si rrjedhojë e pjesëve të ndryshme që vihen në skenë. | | | |
| 23. | | Teatër me kukulla<br>***Faza e parë:* Përzgjedhja e pjesës teatrale dhe ndarja e punës**<br>Punë në grup.<br>Projekt | **Pol Kle dhe teatri i tij i kukullave**<br>Nxënësit/et diskutojnë për teatrin e kukullave dhe përvojat e tyre në shfaqjet e teatrit të kukullave kur ishin të vegjël. Njohja me pasionin e Pol Klesë për të realizuar kukulla dhe skenë të improvizuar me materiale rrethanore, shërben si nxitje për projektin. | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 24 | | Teatër me kukulla<br>***Faza e dytë:***<br>**Realizimi i skenës dhe i kukullave**<br>Punë në grup.<br>Projekt | **Mënyrat e ndryshme të realizimit të kukullave dhe të skenës**<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi idetë dhe për mënyrat e ndryshme të realizimit të kukullave dhe skenës. Shembuj të ndryshëm të kukullave të dorës dhe skenave, nxisin fantazinë e tyre. | | | |
| 25 | | Teatër me kukulla<br>***Faza e tretë:***<br>**Realizimi i shfaqjes teatrale përpara publikut**<br>Punë në grup.<br>Projekt | **Puna përgatitore përpara shfaqjes**<br>Nxënësit/et nëpërmjet provave parapërgatiten për të dhënë shfaqjen. Çdo anëtar i grupit kujdeset që të gjithë elementet e shfaqjes të funksionojnë mirë. | | | |

# 3.5 Planifikimi ditor bazuar në situata të të nxënit (janar-mars)

## *14. Planifikimi ditor* *data....................................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Teknika stampimi dekorative | | **Situata e të nxënit: Teknikat e stampimit dhe mënyrat e përdorimit**<br>Nëpërmjet imazheve me teknika stampimi të ndryshme dekorative, mësuesi/ja i fton nxënësit/et t'i kujtojnë ato, duke shpjeguar edhe karakteristikat e tyre, me të cilat ata/ato janë njohur më parë. Të tilla si: *Stampa me reliev*, *stampa me gdhendje* apo *stampa me letër*. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikave dekorative të stampimit;<br>- përdor me kompetencë teknika stampimi për qëllime dekorative;<br>- krijon me teknika të ndryshme stampimi, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikave të stampimit. | | **Fjalët kyçe:**<br>- stampa me reliev;<br>- stampa me gdhendje;<br>- stampa me letër;<br>- stampa me modele të gatshme;<br>- teknika stampimi dekorative. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime me teknika stampimi të ndryshme;<br>- mjete të tilla, si: modele stampash, bojëra uji, mbështetëse për stampim (pëlhurë, letër etj.). | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. | |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | | | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nëpërmjet imazheve me teknika stampimi të ndryshme dekorative, mësuesi/ja i fton nxënësit/et t'i kujtojnë ato, duke shpjeguar edhe karakteristikat e tyre, me të cilat ata/ato janë njohur më parë. Të tilla si: *Stampa me reliev*, *stampa me gdhendje* apo *stampa me letër*. | | | |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Nxënësit/et orientohen të zgjedhin një teknikë dekorative për të zbukuruar një objekt të thjeshtë. Pasi zgjedhin mjete e duhura për teknikën, ata/ato ndjekin hapat e realizimit të stampimit dekorativ. | | | |

| |
|---|
| Pasi mbarojnë detyrën, nxënësit/et shohin rezultatin e përftuar dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të tij. Nxënësit/et kuptojnë edhe mundësitë e shumta shprehëse që ofrojnë teknikat dekorative të stampimit.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

## *15. Planifikimi ditor* *data...................................*

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Fotografia dhe fotokolazhi | | **Situata e të nxënit: Fotokolazhi**<br>Në imazhin e një fotokolazhi, nxënësit/et zbulojnë elementet që e përbëjnë atë. Duke e krahasuar me një imazh fotografik, nxënësit/et kuptojnë ndryshimin midis fotokolazhit dhe fotografisë. Ata/ato theksojnë karakteristikën e fotografisë "paraqitjen besnike të realitetit" dhe atë të fotokolazhit, i cili përbëhet nga një kolazh me fotografi. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së fotokolazhit;<br>- krijon me teknikën e fotokolazhit, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së fotokolazhit. | | **Fjalët kyçe:**<br>- fotografia;<br>- fotokolazhi;<br>- programe kompjuterike. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe fotokolazhesh të ndryshme;<br>- mjete të tilla, si: imazhe fotografike, gërshërë, ngjitës, bojëra. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>*Lidhje me fushat kurrikulare*:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>*Lidhja me temat ndërkurrikulare*:<br>- njohja e kulturave. | |

| Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Në imazhin e një fotokolazhi, nxënësit/et zbulojnë elementet që e përbëjnë atë. Duke e krahasuar me një imazh fotografik, nxënësit/et kuptojnë ndryshimin midis fotokolazhit dhe fotografisë. Ata/ato theksojnë karakteristikën e fotografisë "paraqitjen besnike të realitetit" dhe atë të fotokolazhit, i cili përbëhet nga një kolazh me fotografi. |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se në fotokolazh pjesë nga imazhe të ndryshme fotografike priten dhe rikompozohen sërish. Teknika e fotokolazhit është e thjeshtë për t'u realizuar, në mënyrë manuale ose nëpërmjet programeve kompjuterike (*photoshop*). Fotokolazhi është një teknikë që të lejon të krijosh imazhe surreale, argëtuese dhe provokuese.<br>Veprimtaria në libër i udhëzon nxënësit/et të krijojnë një autoportret me teknikën e fotokolazhit. Mbas realizimit të fotokolazhit, ata/ato shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit. Nxënësit/et kuptojnë edhe mundësitë e shumta shprehëse dhe të papriturat që ofron teknika e kolazhit.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

## *16. Planifikimi ditor* *data............................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 3 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Dizajni i tekstileve | | **Situata e të nxënit: Llojet e dizajnit të tekstileve**<br>Nëpërmjet shembujve (në imazhe apo shembuj real), nxënësit/et përfshihen në identifikimin e teknikave të ndryshme të dizajnit të tekstileve. Ata/ato identifikojnë endjen, qëndisjen, trikotazhin, ngjyrosjen dhe stampimin si teknika të dizajnit të tekstileve. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon llojet dhe karakteristikat e teknikave të dizajnit të tekstileve;<br>- krijon me teknikën e endje (thurjes), duke përdorur elemente të gjuhës pamore;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse nëpërmjet teknikave të dizajnit të tekstileve. | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- dizajni i tekstileve;<br>- endja;<br>- qëndisja;<br>- trikotazhi;<br>- ngjyrosja;<br>- stampimi;<br>- filli bazë dhe filli ind.<br>- tezgjah ose avlëmend. | |

| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të teknikave të endjes;<br>- mjete të tilla, si: fije akriliku me ngjyra, karton, gërshërë etj. | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare*:**<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare*:**<br>- njohja e kulturave. |
|---|---|
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nëpërmjet shembujve (në imazhe apo shembuj real), nxënësit/et përfshihen në identifikimin e teknikave të ndryshme të dizajnit të tekstileve. Ata/ato identifikojnë endjen, qëndisjen, trikotazhin, ngjyrosjen dhe stampimin si teknika të dizajnit të tekstileve. | |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon karakteristikat e fijes tekstile, endjen, ngjyrosjen dhe përpunimet që e shndërrojnë atë në pëlhurë. Nëpërmjet imazheve, nxënësit/et njihen me makinën e endjes që quhet tezgjah apo avlëmend. Endja kryhet nga thurja e fijeve vertikale (filli bazë) me ato horizontale (filli ind). Nëpërmjet endjes përftohen pëlhura për veshje dhe qilimat për shtëpinë.<br>Veprimtaritë në libër i orientojnë nxënësit/et të endin një mbulesë apo një byzylyk. Pasi mbarojnë detyrën, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të endjes dhe llojet e saj. Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. | |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. | |

## *17. Planifikimi ditor* *data..........................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Dizajni i modës | | **Situata e të nxënit: Dizajni i modës dhe funksioni i veshjes**<br>Nxënësit/et ftohen të diskutojnë mbi modën dhe mënyrën se si u pëlqen të vishen. Ata/ato diskutojnë mbi funksionet e veshjes dhe rëndësinë që ajo ka në mënyrën e prezantimit të njeriut në shoqëri. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat e punës të një dizenjuesi mode;<br>- realizon një mini projekt për veshje duke përdorur gjuhën pamore dhe teknikën e lapustilave;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për rëndësinë dhe funksionet e veshjes. | | **Fjalët kyçe:**<br>- dizajni i modës;<br>- dizenjuesi i modës;<br>- veshja si komunikim;<br>- projekt për veshje. | |

| **Burimet/mjetet/materialet:** | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.** |
|---|---|
| - fotografi që ilustrojnë krijime të dizajnit të modës;<br>- mjete të tilla, si: letër, laps, lapustila. | ***Lidhje me fushat kurrikulare*:**<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare*:**<br>- njohja e kulturave. |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nxënësit/et ftohen të diskutojnë mbi modën dhe mënyrën se si u pëlqen të vishen. Ata/ato diskutojnë mbi funksionet e veshjes dhe rëndësinë që ajo ka në mënyrën e prezantimit të njeriut në shoqëri. | |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Nxënësit/et njihen me punën e një dizenjuesi mode. Ata/ato identifikojnë që veprat e artit sjellin një arkiv të pasur të mënyrës se si njerëzit janë veshur në periudha të ndryshme kohore. Nxënësit/et nxiten të ideojnë dhe të skicojnë veshje.<br>Veprimtaria në libër i udhëzon ata/ato të krijojnë një mini projekt prej tri ose katër veshjesh. Shembujt në libër tregojnë qartë elementet e përbashkëta në veshjet e një koleksioni, por edhe mënyrën e zhvillimit të tyre nga veshja në veshje, e cila tregon larmi brenda llojit. Pasi mbarojnë detyrën, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi koleksionin e krijuar dhe elementet që kanë përdorur.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. | |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. | |

## *18. Planifikimi ditor* *data............................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br>**Tema mësimore**: Skulptura. Modelimi (ora e parë) | | **Situata e të nxënit: Modelimi me materiale të ndryshme**<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi teknikën e modelimit dhe karakteristikat e saj. Ata/ato diskutojnë për materialet e ndryshme që përdoren në teknikën e modelimit si: plastelinë, letër të lagur, tel apo edhe tekstile. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së modelimit në materiale të ndryshme; | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- modelimi me materiale të ndryshme;<br>- modelimi me letër;<br>- modelimi me tel;<br>- modelimi me plastelinë;<br>- armatura. | |

<table>
<tr><td>- përdor me kompetencë teknikën e modelimit me plastelinë apo letër;<br>- krijon figurën e njeriut nëpërmjet teknikës së modelimit, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së modelimit.</td><td></td></tr>
<tr><td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe të skulpturave të realizuara nëpërmjet teknikës së modelimit dhe me materiale të ndryshme;<br>- mjete të tilla, si: tel, letër alumini, letër ngjitëse shirit, plastelinë ose letër e lagur me vinonil.</td><td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi teknikën e modelimit dhe karakteristikat e saj. Ata/ato diskutojnë për materialet e ndryshme që përdoren në teknikën e modelimit si: plastelinë, letër të lagur, tel apo edhe tekstile.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Në imazhe të ndryshme, nxënësit/et identifikojnë armaturën. Mësuesi/ja shpjegon që skulptura të bëhet e qëndrueshme, fillimisht realizohet një skelet metali që quhet strukturë. Mbi strukturën shtohet pak nga pak balta (ose plastelina, letra e lagur, allçia etj.) derisa e mbulon të tërën. Materiali i shtuar, më pas fillon të marrë formën e duhur hap pas hapi, nëpërmjet modelimit me dorë dhe mjeteve të tjera.<br>Veprimtaritë në libër orientojnë nxënësit/et të realizojnë një portret, nëpërmjet modelimit me letër, ose një figurë të modeluar mbi armaturë. Duke u mbështetur në stilin e artistes Niki de San Fal, nxënësit/et realizojnë një figurë të bëshme. Në orën e parë, nxënësit/et realizojnë armaturën me tel dhe e mbështjellin me fletë alumini dhe më pas me letër ngjitëse. Në fund të orës diskutojnë për mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Vlerësimi i nxënësit<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve.</td></tr>
</table>

## *19. Planifikimi ditor* *data............................*

<table>
<tr><td>Fusha: Arte</td><td>Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: IX</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Teknika dhe procese artistike<br><br>Tema mësimore: Skulptura. Modelimi (ora e dytë)</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Modelimi i figurës mbi armaturë<br>Nxënësit/et diskutojnë për karakteristikat e modelimit në skulpturë të artistes (së marrë si referim) dhe si do të pasqyrohet kjo në punën e tyre. Nxënësit/et përmes imazheve identifikojnë që, karakteristikë e veprave të artistes, përveç formës, është edhe përdorimi i ngjyrave të pastra.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së modelimit në materiale të ndryshme;<br>- përdor me kompetencë teknikën e modelimit me plastelinë apo letër;<br>- krijon figurën e njeriut nëpërmjet teknikës së modelimit, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së modelimit.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br><br>- modelimi me materiale të ndryshme;<br>- modelimi me letër;<br>- modelimi me tel;<br>- modelimi me plastelinë;<br>- armatura.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe që ilustrojnë reklama me mesazhe të ndryshme;<br>- mjete të tilla, si: tel, letër alumini, letër ngjitëse shirit, plastelinë ose letër e lagur me vinonil, tempera.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Nxënësit/et diskutojnë për karakteristikat e modelimit në skulpturë të artistes (së marrë si referim) dhe si do të pasqyrohet kjo në punën e tyre. Nxënësit/et përmes imazheve identifikojnë që, karakteristikë e veprave të artistes, përveç formës, është edhe përdorimi i ngjyrave të pastra.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Pasi kanë ndërtuar skeletin e telit për figurën e njeriut dhe e kanë mbështjellë me letër alumini dhe me letër ngjitëse, nxënësit/et zgjedhin lëvizjen dhe modelojnë me plastelinë ose me letër të lagur me vinovil, figurën e njeriut të dëshiruar. Pasi i japin karakterin e formës dhe lëvizjes nëpërmjet modelimit, nxënësit/et e ngjyrosin figurën me tempera. Ata/ato orientohen të përdorin figuracione të ndryshme. Kur mbarojnë detyrën, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato kuptojnë edhe mundësitë e shumta shprehëse që ofron teknika e modelimit.<br>Punimet ekspozohen në klasë dhe ruhen në portofolin e nxënësit.</td></tr>
</table>

| ***Vlerësimi i nxënësit*** |
|---|
| Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

## *20. Planifikimi ditor* *data..................................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Skulptura. Gdhendja | | **Situata e të nxënit: Gdhendja mbi materiale të ndryshme**<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi njohuritë në teknikën e gdhendjes, mjetet dhe materialet që përdoren. Nëpërmjet imazheve, ata/ato identifikojnë gdhendjen e materialeve të ndryshme si atë të gurit, drurit, akullit, frutave, (për arsye dekorative). | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së gdhendjes;<br>- përdor me kompetencë mjetet e gdhendjes mbi materiale të buta;<br>- krijon me teknikën e gdhendjes (në bukë peshku ose sapun), duke përdorur elemente të gjuhës pamore;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së gdhendjes mbi materiale të ndryshme. | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- gdhendje mbi materiale të ndryshme;<br>- gdhendje në gur;<br>- gdhendje në dru;<br>- gdhendje në akull;<br>- gdhendje mbi fruta dhe perime;<br>- gdhendje në bukë peshku (polesterol). | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të procesit të gdhendjes mbi materiale të ndryshme;<br>- mjete të tilla, si: polesterol ose sapun, laps, thikë. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. | |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | | | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi njohuritë në teknikën e gdhendjes, mjetet dhe materialet që përdoren. Nëpërmjet imazheve, ata/ato identifikojnë gdhendjen e materialeve të ndryshme si atë të gurit, drurit, akullit, frutave, (për arsye dekorative). | | | |

| |
|---|
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon procesin e gdhendjes në bukë peshku. Veprimtaritë në libër i orientojnë nxënësit/et si të realizojnë gdhendjen e një skulpture abstrakte në bukë peshku, duke u mbështetur në një punë abstrakte të Henri Murit, ose të realizojnë një personazh në sapun. Procesi i gdhendjes, në të dyja rastet, është i njëjtë: vizatimi i faqeve të kubit, heqja e masave të mëdha të materialit dhe realizimi i detajeve. Mësuesi/ja porosit të përdorin me kujdes thikën, gjatë gdhendjes. Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të gdhendjes dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato kuptojnë edhe mundësitë e shumta shprehëse që ofron teknika e gdhendjes.<br>Punimet ekspozohen në klasë dhe ruhen në portofolin e nxënësit. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

## *21. Planifikimi ditor* *data..................................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Derdhja | | **Situata e të nxënit: Forma pozitive dhe forma negative.**<br>Duke vëzhguar imazhin e një kallëpi të një objekti dhe objektin, nxënësit/et identifikojnë formën negative dhe pozitive në procesin e derdhjes. Gjithashtu, ata/ato identifikojnë kallëpin një pjesësh për relievin dhe dy pjesësh për skulpturën e rrumbullakët. Ata/ato sjellin shembuj të ndryshëm nga riprodhimi i objekteve në industri. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së derdhjes;<br>- përdor me kompetencë materialin e allçisë për të realizuar një derdhje të një objekti të thjeshtë;<br>- krijon me teknikën e derdhjes, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së derdhjes. | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- skulptura;<br>- forma pozitive, forma negative;<br>- kallëpi njëpjesësh;<br>- kallëpi dypjesësh. | |

| Burimet/mjetet/materialet: | Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare. |
|---|---|
| - teksti i nxënësit;<br>- imazhe që ilustrojnë procesin e derdhjes;<br>- mjete të tilla, si: pluhur allçie, ujë, enë për tretje, kallëp i gatshëm. | ***Lidhje me fushat kurrikulare*:**<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare*:**<br>- njohja e kulturave. |

| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Duke vëzhguar imazhin e një kallëpi të një objekti dhe objektin, nxënësit/et identifikojnë formën negative dhe pozitive në procesin e derdhjes. Gjithashtu ata/ato identifikojnë kallëpin një pjesësh për relievin dhe dy pjesësh për skulpturën e rrumbullakët. Ata/ato sjellin shembuj të ndryshëm nga riprodhimi i objekteve në industri. |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Nxënësit/et identifikojnë që materiali që përdoret për t'u hedhur në kallëp duhet të jetë i lëngët ose i butë. Ata/ato nxiten të përdorin një kallëp të gatshëm për të derdhur një objekt të thjeshtë dizajni. (Vazo etj.). Nxënësit/et ndjekin hapat e duhura për të realizuar një vazo apo një mbajtëse qiriri me derdhje, duke zgjedhur dhe manipuluar formën e tij.<br>Pasi mbarojnë detyrën, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të objektit dhe për karakteristikat e teknikës së derdhjes.<br>Objekti ruhet në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

## *22. Planifikimi ditor* *data.....................................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Konstruksioni. Skenografia e teatrit | | **Situata e të nxënit: Shumëllojshmëria e skenografisë së teatrit**<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi përvojat e tyre në teatër, apo njohuritë që kanë mbi teatrin. Nxënësit/et identifikojnë hapësirat që përbëjnë teatrin dhe shumëllojshmërinë e skenografisë si rrjedhojë e pjesëve të ndryshme që vihen në skenë. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat dhe shumëllojshmërinë e skenografisë teatrale; | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- skenografi teatrale;<br>- hapësira e skenës për aktorët;<br>- hapësira e publikut;<br>- teatri i kukullave;<br>- lloje të ndryshme të teatrit të kukullave. | |

| | |
|---|---|
| - përdor me kompetencë materiale të ndryshme për të krijuar një skenë në miniaturë për teatër kukullash;<br>- krijon një skenë në miniaturë për teatër kukullash, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për karakteristikat e skenografisë së teatrit të kukullave. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe nga skena e teatrit dhe nga teatri i kukullave;<br>- mjete të tilla, si: *kuti kartoni, laps, vizore, gërshërë, ngjitëse, bojëra, letra me ngjyra etj.* | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. |

| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi përvojat e tyre në teatër, apo njohuritë që kanë mbi teatrin. Nxënësit/et identifikojnë hapësirat që përbëjnë teatrin dhe shumëllojshmërinë e skenografisë si rrjedhojë e pjesëve të ndryshme që vihen në skenë. |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se skenografia përfshin një bashkësi elementesh artistike, si: piktura, konstruksionet tredimensionale, kostumet, por edhe elementesh teknike, si: ndriçimi, zëri etj. Nëpërmjet tyre skenografi rindërton në mënyrë realiste, të idealizuar ose simbolike mjedisin e veprimit në teatër, pra skenografinë. Gjithashtu nxënësit/et njihen me teatrin e kukullave si një nga format më antike të teatrit dhe lloji më popullor i tij. Ata/ato identifikojnë disa nga llojet më të njohura të teatrit të kukullave.<br>Nxënësit/et ndahen në grupe për të realizuar një moket skenografie për teatër kukullash. Ata/ato ndjekin hapat e duhur nga ana teknike, duke bërë edhe interpretimin e tyre në realizimin e moketit të skenës. Pasi mbarojnë detyrën, shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të skenës së tyre dhe mënyrat alternative për realizimin e skenave për kukulla.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

## *23. Planifikimi ditor* *data............................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa:** IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Teatër me kukulla<br>***Faza e parë:* Përzgjedhja e pjesës teatrale dhe ndarja e punës**<br>Punë në grup. Projekt | | **Situata e të nxënit: Pol Kle dhe teatri i tij i kukullave**<br>Nxënësit/et diskutojnë për teatrin e kukullave dhe përvojat e tyre në shfaqjet e teatrit të kukullave kur ishin të vegjël. Njohja me pasionin e Pol Klesë për të realizuar kukulla dhe skenë të improvizuar me materiale rrethanore, shërben si nxitje për projektin. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon mundësitë e ndryshme të realizimit të kukullave dhe skenës;<br>- përzgjedh pjesën teatrale dhe ndan punën me anëtarët e grupit;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për pjesën teatrale të zgjedhur dhe detyrat e caktuara. | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- pjesa teatrale;<br>- detyrat e anëtarëve;<br>- elementet e teatrit të kukullave (skena, kukullat, muzika, personazhet, aktorët etj.). | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe ku shfaqen kukullat e realizuara nga Pol Kle;<br>- mjete të tilla, si: pjesë letrare të përshtatshme për teatër kukullash. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare*:**<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teatri;<br>- muzika;<br>- teknologjia.<br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare*:**<br>- njohja e kulturave. | |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | | | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nxënësit/et diskutojnë për teatrin e kukullave dhe përvojat e tyre në shfaqjet e teatrit të kukullave kur ishin të vegjël. Njohja me pasionin e Pol Klesë për të realizuar kukulla dhe skenë të improvizuar me materiale rrethanore, shërben si nxitje për projektin. | | | |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të përzgjedhin një pjesë letrare për fëmijë (përrallë, legjendë, tregim etj.) dhe me ndihmën e mësuesit/es së letërsisë të përshtatin dialogët e personazheve për teatrin. Ata/ato bëjnë një plan pune dhe ndajnë detyrat për secilin anëtar të grupit. Përcaktojnë anëtarët që do të merren me realizimin e skenës, ata/ato që do të merren me realizimin e kukullave dhe ata/ato që do të përzgjedhin muzikën. Përcaktoni aktorët dhe pjesët që ata/ato do të interpretojnë. Çdo anëtar mund të ketë më tepër se një detyrë. | | | |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. | | | |

## *24. Planifikimi ditor* *data............................*

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |

| | |
|---|---|
| **Tematika:** Teatër me kukulla<br>***Faza e dytë:*** **Realizimi i skenës dhe i kukullave**<br>Punë në grup. Projekt | **Situata e të nxënit: Mënyrat e ndryshme të realizimit të kukullave dhe të skenës**<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi idetë dhe për mënyrat e ndryshme të realizimit të kukullave dhe skenës. Shembuj të ndryshëm të kukullave të dorës dhe skenave, nxisin fantazinë e tyre. |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat e kukullave dhe skenave të realizuara me materiale të ndryshme;<br>- përdor me kompetencë materiale të ndryshme për të realizuar kukullat e dorës;<br>- krijon kukullat dhe skenën për teatrin e kukullave;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mënyrat e shumta të krijimit të kukullave dhe skenave. | **Fjalët kyçe:**<br>- skicë idetë;<br>- kukulla me çorape;<br>- kukulla me letër;<br>- kukulla më materiale të ndryshme;<br>- skena të ndryshme për teatër kukullash. |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe të kukullave të realizuara me materiale të ndryshme;<br>- *materialet zgjidhen sipas llojit të skenës dhe kukullave që do të realizohen.* | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teatri;<br>- muzika;<br>- teknologjia.<br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. |

| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi idetë dhe për mënyrat e ndryshme të realizimit të kukullave dhe skenës. Shembuj të ndryshëm të kukullave të dorës dhe skenave, nxisin fantazinë e tyre. |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja i udhëzon të diskutojnë në grup skicat dhe idetë për realizimin e skenës e po ashtu skicat dhe idetë për mënyrat e ndryshme të realizimit të kukullave. Nxënësit/et realizojnë skenën dhe kukullat, sipas ideve të miratuara nga grupi. (me mënyrën e realizimit të skenës ata/ato janë njohur një orë më parë). Gjithashtu, nxënësit/et realizojnë edhe kukullat e dorës sipas karakteristikave të personazheve të pjesës së zgjedhur. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

## *25. Planifikimi ditor* *data............................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teatër me kukulla<br>*Faza e tretë:* **Realizimi i shfaqjes teatrale përpara publikut**<br>Punë në grup. Projekt | | **Situata e të nxënit: Puna përgatitore përpara shfaqjes**<br>Nxënësit/et nëpërmjet provave parapërgatiten për të dhënë shfaqjen. Çdo anëtar i grupit kujdeset që të gjithë elementet e shfaqjes të funksionojnë mirë. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon që të gjithë elementet përbërës të teatrit kanë të njëjtën rëndësi për realizimin me sukses të shfaqjes;<br>- realizon shfaqjen duke përdorur me kompetencë elementet e teatrit të kukullave;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për realizimin e shfaqjes dhe mënyrën e funksionimit të elementeve të saj. | | **Fjalët kyçe:**<br>- shfaqje e teatrit të kukullave;<br>- elemente të teatrit të kukullave. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe të skulpturave lëvizëse dhe imazhe që demonstrojnë mënyrën e ndërtimit të skulpturave lëvizëse;<br>- mjete të tilla, si: shkopinj, fije dhe peshat që mund të jenë letër, plastikë ose kombinimi i të dyjave. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teatri;<br>- muzika;<br>- teknologjia.<br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. | |

**Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve**

***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***

Nxënësit/et nëpërmjet provave parapërgatiten për të dhënë shfaqjen. Çdo anëtar i grupit kujdeset që të gjithë elementet e shfaqjes të funksionojnë mirë.

***Ndërtimi i njohurive të reja***

Në fazën e fundit nxënësit/et japin shfaqje përpara nxënësve të klasave fillore. Më pas ata/ato diskutojnë: Si u prit shfaqja nga "spektatorët"? A qe një shfaqje e suksesshme? A funksionuan ashtu siç duhet të gjithë elementet e shfaqjes? etj.

Punimet (dhe filmimet, nëse është e mundur) ruhen në portofolin e nxënësit/es.

***Vlerësimi i nxënësit***

Ky vlerësim do të fokusohet:
- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve.

## 3.6 Planifikimi tematik për tremujorin e tretë prill-qershor

| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe |
|---|
| **Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit**<br>Nxënësi/ja:<br>• zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv/e në veprimtaritë artistike;<br>• gjykon drejt mesazhet, që u adresohet;<br>• shprehet qartë dhe saktë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale;<br>• komunikon qartë mendimin e tij/saj;<br>• shfrytëzon në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese, mjetet artistike e mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme.<br>**Kompetenca e të menduarit**<br>Nxënësi/ja:<br>• përpunon njohuritë vizuale në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;<br>• zgjidh në mënyrë të pavarur probleme të ndryshme artistike;<br>• zhvillon aftësitë për të menduar dhe për të argumentuar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese;<br>• ndjek me vëmendje udhëzimet për të realizuar një krijim, apo veprimtari artistike.<br>**Kompetenca e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• përzgjedh në mënyrë të pavarur mjetet për të realizuar një krijim artistik;<br>• përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim;<br>• zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.<br>**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**<br>Nxënësi/ja:<br>• drejton dhe merr pjesë aktive në aktivitete të artit pamor si brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese;<br>• kupton dhe gjen zgjidhje në mënyrë të pavarur për problemet ekologjike, duke u ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. |

**Kompetenca qytetare**

Nxënësi/ja:

- diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore;
- respekton punën e vet dhe të të tjerëve;
- bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës, për një qëllim të përbashkët.

**Kompetenca personale**

Nxënësi/ja:

- krijon besimin te vetja gjatë veprimtarive artistike;
- merr pjesë në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe në komunitet;
- ndërgjegjëson veten dhe zhvillon vetëbesimin dhe krijimin e besimit te të tjerët.

**Kompetenca digjitale**

Nxënësi/ja:

- gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion, si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet;
- përdor mjetet të ndryshme në funksion të informacionit artistik, si: video *CD, DVD*, aparat fotografik digjital, kamera etj.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës**

**Krijimi artistik**

Nxënësi/ja:

- përdor ide personale, elementet e gjuhës pamore dhe stimuj për krijim;
- zbulon rrugë të ndryshme të kombinimit të elementeve të artit pamor për të realizuar idetë artistike;
- përdor hapat e procesit krijues, elementet e artit pamor dhe teknikat artistike;
- përzgjedh elementet e duhura për të realizuar idetë artistike në tema të personalizuara;
- përmirëson punën duke u mbështetur tek eksperimenti dhe në zgjidhje të ndryshme artistike;
- analizon burime të ndryshme informacioni dhe qëllimin e tij/saj krijues;
- identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në krijim, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.

**Realizimi i punimit**

Nxënësi/ja:

- përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë në punë dy dhe tredimensionale në art dhe dizajn;
- krijon punë origjinale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra ose nëpërmjet kujtesës së tij mbi objektet njerëzit etj., ose nëpërmjet imagjinatës duke përdorur mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike;
- vlerëson eksperiencat e tij krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit;
- zgjedh ide dhe planifikon teknikat dhe mjetet e duhura për realizim;
- eksperimenton me mjetet shprehëse të mjeteve dhe teknikave të ndryshme artistike për të materializuar idetë e tij/saj;
- analizon teknika të ndryshme artistike për qëllimin e tij/saj krijues;
- identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në lidhje me realizimin e punimit, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.

**Vlerësimi artistik**

Nxënësi/ja:

- analizon dhe interpreton elementet e gjuhës vizuale, organizimin e tyre, teknikën, gjininë në një vepër arti;
- identifikon dhe vlerëson veprat e artit në aspektin e tyre historik dhe social-kulturor;
- identifikon dhe argumenton aspektin shprehës dhe simbolik të veprës së artit, punës së tij/saj dhe shokut/shoqes, duke shprehur emocionet e tij/saj;
- interpreton, argumenton dhe shpreh këndvështrimin e tij/saj për një vepër arti, për një objekt artistik, për punimin e tij/saj, dhe për atë të shokut/shoqes;
- përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe për të komentuar veprat e artit, punën e tij/saj, atë të shokut/shoqes dhe eksperiencën e tij/saj artistike;
- identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në vlerësimin e veprave të artit, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur;
- kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri në periudha të ndryshme historike;
- identifikon një sërë profesionesh që lidhen me artin pamor dhe me karrierën artistike.

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 26 | Historia, arti dhe shoqëria | Postimpresionizmi | **Zbulojmë lëvizjen postimpresioniste**<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura, nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit postimpresionist. Ata/ato njihen me tre artistët përfaqësues të kësaj lëvizjeje artistike nëpërmjet veprave më të njohura të tyre. Me vepra të veçanta të këtyre artistëve nxënësit janë njohur edhe më parë.<br>**Zbulojmë lëvizjen ekspresioniste dhe foviste**<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura, nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e lëvizjes ekspresioniste dhe foviste. Ata/ato njihen edhe me artistët më të njohur të dy rrymave artistike nëpërmjet veprave të tyre më të njohura.<br>**Zbulojmë lëvizjen kubiste dhe abstraksioniste**<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura, nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e kubizmit dhe abstraksionizmit. Dy përfaqësuesit kryesorë, Pikaso për kubizmin dhe Kandinski për abstraksionizmin janë të njohur nga nxënësit/et tashmë. Nxënësit/et krahasojnë edhe veprat e artit të dy lëvizjeve artistike. | Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse<br>Puna në grup dhe puna individuale<br>Hetimi dhe zbulimi<br>Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase<br>Metoda integruese<br>Bashkëbisedim<br>Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues<br>Prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK<br>Projekte kurrikulare | Vlerësim diagnostikues<br>• intervistë me një listë treguesish;<br>• vetëvlerësim me listë kriteresh;<br>Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)<br>• vlerësimi i përgjigjeve me gojë;<br>• vlerësimi i punës në grup;<br>• vlerësim mes nxënësish;<br>• vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;<br>• vlerësimi i detyrave të shtëpisë;<br>• vetëvlerësim;<br>• intervistë me një listë treguesish;<br>• vëzhgim me një listë të plotë treguesish;<br>• portofol;<br>• prezantim me gojë ose me shkrim;<br>• projekt kurrikular. | Teksti i artit pamor për klasën e VI<br>Materiale nga interneti<br>Ilustrime veprash arti<br>Ilustrime të imazheve nga natyra në përshtatje me tema të caktuara<br>Fotografi të objekteve të artit, dizajnit, artizanatit dhe trashëgimisë kulturore<br>Slide/materiale të krijuara nga mësuesit/et<br>Modele të detyrave nga nxënësit/et |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 27 | | Ekspresionizmi dhe fovizmi | | | | |
| 28 | | Kubizmi dhe abstraksionizmi | | | | |
| 29 | | Dadaizmi dhe surealizmi | **Zbulojmë lëvizjen dada dhe surrealiste** Nëpërmjet imazheve të shfaqura, nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e dadaizmit dhe surealizmit. Ata/ato njihen me artistët më të njohur nëpërmjet veprave të tyre më të njohura. Krahasimi midis lëvizjeve artistike moderniste është strategji e situatës së të nxënit. | | | |
| 30 | | Ekspresionizmi abstrakt dhe pop arti | **Zbulojmë ekspresionizmin abstrakt dhe pop artin** Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e abstraksionizmit abstrakt dhe pop artit. Ata/ato njihen me artistët më të njohur të kësaj periudhe nëpërmjet veprave të tyre më të njohura. Nxënësit/et krahasojnë veprat e ekspresionizmit abstrakt dhe të ekspresionizmit. | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 31 | | Skulptura dhe arkitektura në gjysmën e dytë të shek. XX | **Zbulojmë skulpturën dhe arkitekturën në gjysmën e dytë të shek. XX**<br>Nxënësit/et nëpërmjet imazheve diskutojnë karakteristikat e skulpturës dhe arkitekturës. Ata/ato bëjnë krahasime dhe zbulojnë sesi përdorimi i materialeve të reja dhe i teknologjisë ndikuan në karakteristikat e skulpturës dhe arkitekturës në këtë periudhë. | | | |
| 32 | | Arti në Shqipëri në periudhën e Socializmit | **Zbulojmë artin në Shqipëri në periudhën e socializmit**<br>Nxënësit/et nëpërmjet imazheve të veprave të artit zbulojnë karakteristikat e realizmit socialist dhe mënyrën natyraliste të paraqitjes së subjektit. | | | |
| 33 | | Gjirokastra, Berati dhe arkitektura e tyre tradicionale | **Zbulojmë qytetet muze**<br>Nëpërmjet imazheve të ndryshme nxënësit/et krahasojnë dy qytetet, duke zbuluar kështu edhe karakteristikat e përbashkëta dhe të veçanta të arkitekturës së Gjirokastrës dhe Beratit. | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 34 | | Konkurs me dy skuadra (ose test) | **Verifikoj kompetencat mbi historinë e artit**<br>Nxënësit/et e klasës ndahen në dy skuadra dhe secila prej tyre përgatit pyetjet dhe përgjigjet për skuadrën tjetër. Pyetjet ndërtohen rreth njohurive të marra në tematikën e tretë. Për të ndërtuar një pyetësor, nxënësit/et orientohen nga mësuesi/ja dhe libri. | | | |
| 35 | | Ekspozita e fundvitit | **Diskutime mbi mënyrën e përgatitjes së ekspozitës**<br>Nxënësit/et ndahen në tre skuadra dhe secila prej tyre përzgjedh punimet e një periudhe. Ata/ato diskutojnë së bashku mbi mënyrën e ekspozimit të punëve të përzgjedhura.<br>Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et në një situatë pune të përbashkët, ku bashkëpunimi është çelësi i organizimit të një ekspozite të mirë. | | | |

## 3.7 Planifikimi ditor bazuar në situata të të nxënit (prill-qershor)

***26. Planifikimi ditor*** ***data............................***

<table>
<tr><td>Fusha: Arte</td><td>Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: IX</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Teknika dhe procese artistike<br><br>Tema mësimore: Postimpresionizmi<br>.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Zbulojmë lëvizjen postimpresioniste<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura, nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit postimpresionist. Ata/ato njihen me tre artistët përfaqësues të kësaj lëvizjeje artistike nëpërmjet veprave më të njohura të tyre. Me vepra të veçanta të këtyre artistëve, nxënësit/et janë njohur edhe më parë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon veprat e artit të lëvizjes postimpresioniste;<br>- zbulon karakteristikat e lëvizjes postimpresioniste dhe artistët më përfaqësues;<br>- reflekton mbi veprat e lëvizjes postimpresioniste dhe përzgjedh veprën e një artisti për ta interpretuar sipas vështrimit të tij;<br>- shpreh mendimin e vet rreth gjuhës artistike të lëvizjes postimpresioniste.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br><br>- karakteristikat e postimpresionizmit;<br>- piktura;<br>- skulptura;<br>- fakte interesante rreth postimpresionizmit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave të artit postimpresionist;</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat e shoqërore.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura, nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit postimpresionist. Ata/ato njihen me tre artistët përfaqësues të kësaj lëvizjeje artistike nëpërmjet veprave më të njohura të tyre. Me vepra të veçanta të këtyre artistëve, nxënësit/et janë njohur edhe më parë.</td></tr>
</table>

| ***Ndërtimi i njohurive të reja*** |
| --- |
| Mësuesi/ja shpjegon termin postimpresionist dhe periudhën kur u zhvillua kjo lëvizje artistike. Nëpërmjet rubrikës "artistë dhe vepra", nxënësit/et njihen me karakteristikat e artistëve përfaqësues dhe me veprat që i prezantojnë më mirë këto karakteristika. Rubrika "fakte interesante" përmban kuriozitete në formën e fakteve artistike dhe shërben si një përmbledhje e njohurive të marra. Veprimtaria i fton nxënësit/et të vëzhgojnë "brendia e dhomës" së Van Gogut dhe përditësimit që i ka bërë Roi Lihtenshtein asaj, sipas stilit të tij të punimit. Nxënësit/et ftohen të përditësojnë edhe ata/ato këtë vepër sipas këndvështrimit të tyre.<br>Detyra zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe plotësohet si detyrë shtëpie.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** |
| Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

## *27. Planifikimi ditor* *data............................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
| --- | --- | --- | --- |
| **Tematika:** Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>**Tema mësimore**: Ekspresionizmi dhe fovizmi | | **Situata e të nxënit: Zbulojmë lëvizjen ekspresioniste dhe foviste**<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura, nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e lëvizjes ekspresioniste dhe foviste. Ata/ato njihen me artistët më të njohur të dy rrymave artistike nëpër veprave të tyre më të njohura. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon veprat e artit të lëvizjes ekspresioniste dhe foviste;<br>- zbulon karakteristikat e lëvizjes ekspresioniste, foviste dhe artistët më përfaqësues;<br>- reflekton mbi veprat e artit të këtyre periudhave dhe përzgjedh veprën e një artisti për ta interpretuar sipas vështrimit të tij;<br>- shpreh mendimin e vet rreth gjuhës artistike të lëvizjes ekspresioniste dhe foviste. | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- karakteristikat e ekspresionizmit;<br>- karakteristikat e fovizmit;<br>- piktura;<br>- kolazhi;<br>- fakte interesante rreth ekspresionizmit dhe fovizmit. | |

| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave të artit të lëvizjes ekspresioniste dhe foviste. | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. |
|---|---|
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura, nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e lëvizjes ekspresioniste dhe foviste. Ata/ato njihen me artistët më të njohur të dy rrymave artistike nëpër veprave të tyre më të njohura. | |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon termin ekspresionizëm dhe fovizëm dhe periudhën kur lindën këto lëvizje artistike. Nëpërmjet rubrikës "artistë dhe vepra", nxënësit/et njihen me karakteristikat e artistëve përfaqësues dhe me veprat që i prezantojnë më mirë këto karakteristika. Rubrika "fakte interesante" përmban kuriozitete në formën e fakteve artistike dhe shërben si një përmbledhje e njohurive të marra. Veprimtaria i fton nxënësit/et të vëzhgojnë kolazhet e Matisit dhe teknikën që ka përdorur ai për realizimin e tyre. Duke u mbështetur në teknikën e kolazheve të Matisit, nxënësit/et ftohen të realizojnë kolazhin e tyre.<br>Detyra zhvillohet në mënyrë të pavarur, dhe mund të plotësohet si detyrë shtëpie.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. | |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;<br>▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;<br>▪ në realizimin e detyrës së dhënë. | |

## *28. Planifikimi ditor* *data............................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>**Tema mësimore**: Kubizmi dhe abstraksionizmi | | **Situata e të nxënit: Zbulojmë lëvizjen kubiste dhe abstraksioniste**<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura, nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e kubizmit dhe abstraksionizmit. Dy përfaqësuesit kryesorë, Pikaso për kubizmin dhe Kandinski për abstraksionizmin janë të njohur nga nxënësit tashmë. Nxënësit/et krahasojnë edhe veprat e artit të dy lëvizjeve artistike. | |

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon veprat e artit të lëvizjes kubiste dhe abstraksioniste;<br>- zbulon karakteristikat e lëvizjes kubiste dhe abstraksioniste dhe artistët më përfaqësues;<br>- reflekton mbi veprat e artit të këtyre periudhave dhe përzgjedh veprën e një artisti për ta interpretuar sipas vështrimit të tij;<br>- shpreh mendimin e vet rreth gjuhës artistike të lëvizjes kubiste dhe abstraksioniste.</td><td>Fjalët kyçe:<br><br>- karakteristikat e kubizmit;<br>- karakteristikat e abstraksionizmit;<br>- piktura;<br>- kolazhi;<br>- fakte interesante rreth kubizmit dhe abstraksionizmit.</td></tr>
<tr><td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave të artit të lëvizjes kubiste dhe abstraksioniste.</td><td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura, nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e kubizmit dhe abstraksionizmit. Dy përfaqësuesit kryesorë, Pikaso për kubizmin dhe Kandinski për abstraksionizmin janë të njohur nga nxënësit/et, tashmë. Nxënësit/et krahasojnë edhe veprat e artit të dy lëvizjeve artistike.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Mësuesi/ja shpjegon termin kubizëm dhe abstraksionizëm dhe periudhën kur lindën këto lëvizje artistike. Nëpërmjet rubrikës “artistë dhe vepra”, nxënësit/et njihen me karakteristikat e artistëve përfaqësues dhe me veprat që i prezantojnë më mirë këto karakteristika. Rubrika “fakte interesante” përmban kuriozitete në formën e fakteve artistike dhe shërben si një përmbledhje e njohurive të marra. Veprimtaria i fton nxënësit/et të vëzhgojnë peizazhet në akuarel në formën e shënimeve të Pol Klesë. Duke u mbështetur në formën abstrakte të paraqitjes dhe në teknikën e akuareleve, nxënësit/et nxiten të interpretojnë një punim sipas Pol Klesë.<br>Detyra zhvillohet në mënyrë të pavarur, dhe mund të plotësohet si detyrë shtëpie.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Vlerësimi i nxënësit<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;<br>▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;<br>▪ në realizimin e detyrës së dhënë.</td></tr>
</table>

## *29. Planifikimi ditor*      *data............................*

<table>
<tr><td>Fusha: Arte</td><td>Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: IX</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>Tema mësimore: Dadaizmi dhe surealizmi</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Zbulojmë lëvizjen dada dhe surrealiste<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura, nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e dadaizmit dhe surealizmit. Ata/ato njihen me artistët më të njohur nëpërmjet veprave të tyre më të njohura. Krahasimi midis lëvizjeve artistike moderniste është strategji e situatës së të nxënit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon veprat e artit të lëvizjes dadaiste dhe surealiste;<br>- zbulon karakteristikat e lëvizjes dadaiste, surealiste dhe artistët më përfaqësues;<br>- reflekton mbi veprat e artit të këtyre lëvizjeve dhe përzgjedh veprën e një artisti për ta interpretuar sipas vështrimit të tij;<br>- shpreh mendimin e vet rreth gjuhës artistike të lëvizjes dadaiste dhe surealiste.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br><br>- karakteristikat e dadaizmit;<br>- karakteristikat e surrealizmit;<br>- piktura;<br>- kolazhi;<br>- redy-made (të gatshme);<br>- fakte interesante rreth dadaizmit dhe surealizmit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave të artit të lëvizjes dadaiste dhe surealiste.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura, nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e dadaizmit dhe surealizmit. Ata/ato njihen me artistët më të njohur nëpërmjet veprave të tyre më të njohura. Krahasimi midis lëvizjeve artistike moderniste është strategji e situatës së të nxënit.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| ***Ndërtimi i njohurive të reja*** <br> Mësuesi/ja shpjegon termin dada dhe surealizëm dhe periudhën kur lindën këto lëvizje artistike. Nëpërmjet rubrikës "artistë dhe vepra" nxënësit/et njihen me karakteristikat e artistëve përfaqësues dhe me veprat që i prezantojnë më mirë këto karakteristika. Rubrika "fakte interesante" përmban kuriozitete në formën e fakteve artistike dhe shërben si një përmbledhje e njohurive të marra. Veprimtaria i fton nxënësit/et të vëzhgojnë fotokolazhin surrealist të Rëne Magridit. Duke u mbështetur në karakteristikën e paraqitjes dhe në teknikën e kolazhit, nxënësit/et nxiten të krijojnë një fotokolazh surealist sipas Rëne Magridit. <br> Detyra zhvillohet në mënyrë të pavarur, dhe mund të plotësohet si detyrë shtëpie. <br> Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit*** <br> Ky vlerësim do të fokusohet: <br> ▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re; <br> ▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor; <br> ▪ në realizimin e detyrës së dhënë. |

## *30. Planifikimi ditor* *data............................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Historia, arti dhe shoqëria. <br><br> **Tema mësimore**: Ekspresionizmi abstrakt dhe pop arti | | **Situata e të nxënit: Zbulojmë ekspresionizmin abstrakt dhe pop artin** <br> Nëpërmjet imazheve të shfaqura, nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e abstraksionizmit abstrakt dhe pop artit. Ata/ato njihen me artistët më të njohur të kësaj periudhe nëpërmjet veprave të tyre më të njohura. Nxënësit/et krahasojnë veprat e ekspresionizmit abstrakt dhe të ekspresionizmit. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:** <br> Nxënësi/ja: <br> - vëzhgon veprat e artit të ekspresionizmit abstrakt dhe pop artit; <br> - zbulon karakteristikat e ekspresionizmit abstrakt, pop artit dhe artistët më përfaqësues; <br> - reflekton mbi veprat e artit të këtyre lëvizjeve dhe përzgjedh veprën e një artisti për ta interpretuar sipas vështrimit të tij; <br> - shpreh mendimin e vet rreth subjekteve dhe gjuhës artistike të ekspresionizmit abstrakt dhe pop artit. | | **Fjalët kyçe:** <br><br> - karakteristikat e ekspresionizmit abstrakt; <br> - karakteristikat e pop artit; <br> - fakte interesante rreth dadaizmit dhe surealizmit. | |

<table>
<tr><td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave të artit të ekspresionizmit abstrakt dhe pop artit.</td><td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura, nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e abstraksionizmit abstrakt dhe pop artit. Ata/ato njihen me artistët më të njohur të kësaj periudhe nëpërmjet veprave të tyre më të njohura. Nxënësit/et krahasojnë veprat e ekspresionizmit abstrakt dhe të ekspresionizmit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Mësuesi/ja shpjegon termin ekspresionizmi abstrakt dhe pop arti dhe periudhën kur lindën këto lëvizje artistike. Nëpërmjet rubrikës “artistë dhe vepra”, nxënësit/et njihen me karakteristikat e artistëve përfaqësues dhe me veprat që i prezantojnë më mirë këto karakteristika. Rubrika “fakte interesante” përmban kuriozitete në formën e fakteve artistike dhe shërben si një përmbledhje e njohurive të marra. Veprimtaria i fton nxënësit/et të vëzhgojnë mënyrën dhe teknikën e punimit të Pollokut. Duke u mbështetur në karakteristikën e paraqitjes dhe në teknikën e pikëlimit, nxënësit nxiten të krijojnë sipas teknikës së Xhekson Pollok.<br>Detyra zhvillohet në mënyrë të pavarur, dhe mund të plotësohet si detyrë shtëpie.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Vlerësimi i nxënësit<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;<br>▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;<br>▪ në realizimin e detyrës së dhënë.</td></tr>
</table>

## *31. Planifikimi ditor* *data............................*

<table>
<tr><td>Fusha: Arte</td><td>Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: IX</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>Tema mësimore: Skulptura dhe arkitektura në gjysmën e dytë të shek. XX</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Zbulojmë skulpturën dhe arkitekturën në gjysmën e dytë të shek. XX<br>Nxënësit/et nëpërmjet imazheve diskutojnë karakteristikat e skulpturës dhe arkitekturës. Ata/ato bëjnë krahasime dhe zbulojnë se si përdorimi i materialeve të reja dhe i teknologjisë ndikuan në karakteristikat e skulpturës dhe arkitekturës në këtë periudhë.</td></tr>
</table>

| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon veprat e artit të skulpturës dhe arkitekturës së gjysmën e dytë të shek. XX;<br>- zbulon karakteristikat e skulpturës dhe arkitekturës së gjysmën e dytë të shek. XX dhe artistët më përfaqësues;<br>- reflekton mbi arkitekturën e kësaj periudhe dhe zbulon përdorimin e materialeve të reja;<br>- shpreh mendimin e vet rreth gjuhës artistike të skulpturës dhe arkitekturës së gjysmën e dytë të shek. XX. | **Fjalët kyçe:**<br><br>- skulptura;<br>- arkitektura;<br>- elementet arkitektonikë;<br>- materiale plastike dhe informatika. |
|---|---|
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe t*ë* skulpturës dhe arkitekturës së gjysmën e dytë të shek. XX. | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. |

**Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve**

***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

Nxënësit/et nëpërmjet imazheve diskutojnë karakteristikat e skulpturës dhe arkitekturës. Ata/ato bëjnë krahasime dhe zbulojnë se si përdorimi i materialeve të reja dhe i teknologjisë ndikuan në karakteristikat e skulpturës dhe arkitekturës në këtë periudhë.

***Ndërtimi i njohurive të reja***

Mbas vëzhgimeve e diskutimeve në klasë, mësuesi/ja shpjegon shfaqjen e një gjuhe të re artistike dhe të teknikave të reja në skulpturën e gjysmës së shek. XX. Zgjidhje të reja teknike shoqëruan edhe arkitekturën e kësaj periudhe. Nxënësit/et njihen me "artistë, arkitektë dhe vepra" për të kuptuar më mirë karakteristikat e reja të shfaqura në veprat e artit dhe arkitekturës. Veprimtaria i fton nxënësit/et të vëzhgojnë disa vepra arkitektonike të kësaj periudhe dhe të zbulojnë materialet e reja të implementuara në elementët arkitektonikë. Nxënësit/et ftohen të bëjnë një kërkim nëpër revista apo internet dhe gjejnë shembuj të ndryshëm të arkitekturës që të duken interesante për sa i përket përdorimit të materialeve në elementet e jashtëm arkitektonik.

Detyra zhvillohet në mënyrë të pavarur, dhe mund të plotësohet si detyrë shtëpie.

Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.

***Vlerësimi i nxënësit***

Ky vlerësim do të fokusohet:

- në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;
- në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;
- në realizimin e detyrës së dhënë.

## *32. Planifikimi ditor* *data...........................*

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
| **Tematika:** Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>**Tema mësimore**: Arti në Shqipëri në periudhën e socializmit | | **Situata e të nxënit: Zbulojmë artin në Shqipëri në periudhën e socializmit**<br>Nxënësit/et nëpërmjet imazheve të veprave të artit zbulojnë karakteristikat e realizmit socialist dhe mënyrën natyraliste të paraqitjes së subjektit. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon veprat e artit të periudhës së artit në Shqipëri në periudhën e socializmit;<br>- zbulon karakteristikat e artit në Shqipëri në periudhën e socializmit dhe artistët më përfaqësues;<br>- reflekton mbi tematikat e veprave të artit në Shqipëri në periudhën e socializmit;<br>- shpreh mendimin e vet rreth subjekteve dhe gjuhës artistike të artit në Shqipëri në periudhën e socializmit. | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- karakteristikat e artit në Shqipëri në periudhën e socializmit;<br>- metoda e realizmit socialist;<br>- institucionet e artit;<br>- piktura;<br>- skulptura;<br>- artet e aplikuara;<br>- monumentet. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave të artit në Shqipëri në periudhën e socializmi. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. | |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | | | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nxënësit/et nëpërmjet imazheve të veprave të artit zbulojnë karakteristikat e realizmit socialist dhe mënyrën natyraliste të paraqitjes së subjektit. | | | |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se ku lindi metoda e realizmit socialist dhe karakteristikat e kësaj metode. Ndërtimi i institucioneve artistike mundësoi realizimin e qëllimit për ta bërë artin një mjet propagandistik në shërbim të ideologjisë së partisë në pushtet. Mësuesi/ja rendit disa nga emrat e artistëve që mbaruan shkollat e artit në vendet e bllokut socialist dhe sollën me vete edhe metodat e realizmit socialist. Pjesë e njohurive janë edhe gjinitë dhe tematikat e artit që u zhvilluan në këtë periudhë.<br>Veprimtaria i orienton nxënësit/et të vëzhgojnë dhe identifikojnë tematikat e veprave të artit të realizmit socialist të paraqitura në libër. Mënyra e paraqitjes së personazheve, e pozave e veshjes së tyre janë pjesë e diskutimeve.<br>Veprimtaria mund të realizohet nëpërmjet diskutimeve por edhe me shkrim, dhe mund të plotësohet si detyrë shtëpie.<br>Detyrat me shkrim ruhen në portofolin e nxënësit/es. | | | |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;<br>▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;<br>▪ në realizimin e detyrës së dhënë. | | | |

## *33. Planifikimi ditor* *data............................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>**Tema mësimore**: Gjirokastra, Berati dhe arkitektura e tyre tradicionale | | **Situata e të nxënit: Zbulojmë qytetet muze**<br>Nëpërmjet imazheve të ndryshme, nxënësit/et krahasojnë dy qytetet duke zbuluar edhe karakteristikat e përbashkëta dhe të veçanta të arkitekturës së Gjirokastrës dhe Beratit. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon imazhe nga qyteti i Gjirokastrës dhe Beratit;<br>- zbulon karakteristikat e arkitekturës së qyteteve muze, Gjirokastrës dhe Beratit;<br>- reflekton mbi karakteristikat e qyteteve muze si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë sonë kulturore;<br>- shpreh mendimin e vet rreth subjekteve dhe gjuhës artistike të artit në Shqipëri në fillim të shek. XX. | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- Gjirokastra qytet muze;<br>- Berati qytet muze;<br>- UNESCO;<br>- arkitektura e banesave;<br>- ndërtimet e kultit;<br>- trashëgimi kulturore. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe nga qyteti i Gjirokastrës dhe Beratit. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. | |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | | | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nëpërmjet imazheve të ndryshme, nxënësit/et krahasojnë dy qytetet duke zbuluar edhe karakteristikat e përbashkëta dhe të veçanta të arkitekturës së Gjirokastrës dhe Beratit. | | | |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se qyteti i Gjirokastrës dhe ai i Beratit janë regjistruar në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s si një zonë e vetme, për shkak të ngjashmërive që paraqesin si nga ana arkitekturore, ashtu edhe nga ajo kulturore e historike. Mësuesi/ja shpjegon qendrat urbanistike të qyteteve dhe monumentet e tyre kryesore (kalatë, qendrat e qyteteve, banesat, ndërtesat e kultit etj.)<br>Veprimtaria i orienton nxënësit/et të realizojnë kartolina për të promovuar dy qytetet e rëndësishme të trashëgimisë tona kulturore. Ata/ato mund të përdorin teknikat e vizatimit ose atë të fotokolazhit. | | | |

| |
|---|
| Detyra zhvillohet në mënyrë të pavarur, dhe mund të plotësohet si detyrë shtëpie.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;<br>▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;<br>▪ në realizimin e detyrës së dhënë. |

## *34. Planifikimi ditor* *data............................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>**Tema mësimore**: Konkurs me dy skuadra (ose test) | | **Situata e të nxënit: Verifikoj kompetencat mbi historinë e artit**<br>Nxënësit/et e klasës ndahen në dy skuadra dhe secila prej tyre përgatit pyetjet dhe përgjigjet për skuadrën tjetër. Pyetjet ndërtohen rreth njohurive të marra në tematikën e tretë. Për të ndërtuar një pyetësor nxënësit/et orientohen nga mësuesi/ja dhe libri. Nxënësit/et kanë bërë edhe një punë paraprake të mbledhjes së imazheve që do të jenë pjesë e pyetësorit. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- zhvillon aftësitë komunikuese dhe ndërvepruese;<br>- përdor fjalorin e përshtatshëm artistik mbi historinë e artit për të formuluar pyetjet;<br>- diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për ndarjen e punës;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për rezultatet e arritura në konkurs nga skuadra. | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- fjalori artistik;<br>- pyetësor;<br>- konkurs. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- fotografi dhe ilustrime nga vepra të artit që nxënësit/et kanë gjetur për të formuluar pyetjet. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. | |

| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nxënësit/et e klasës ndahen në dy skuadra dhe secila prej tyre përgatit pyetjet dhe përgjigjet për skuadrën tjetër. Pyetjet ndërtohen rreth njohurive të marra në tematikën e tretë. Për të ndërtuar një pyetësor nxënësit/et orientohen nga mësuesi/ja dhe libri. Nxënësit/et kanë bërë edhe një punë paraprake të mbledhjes së imazheve që do të jenë pjesë e pyetësorit. |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të vendosin rregullat e konkurrimit dhe pikët e pyetjeve. Nëpërmjet një shorti ata/ato caktojnë se cila nga skuadrat do të fillojë pyetësorin e para. Gjatë kohës së konkurrimit një nxënës/e mbledh pikët dhe kur skuadra që nuk i përgjigjet pyetjes ose i përgjigjet asaj pjesërisht, skuadra tjetër jep përgjigjen dhe argumenton pikët. Në këtë mënyrë vazhdon konkurrimi deri në përfundim të pyetësorit. Argumentimi i përgjigjeve dhe i pikëve është shumë i rëndësishëm gjatë konkurrimit. Në përfundim të konkurrimit përzgjidhet skuadra fituese sipas numrit të pikëve të mbledhura. Nxënësit/et diskutojnë për mënyrën e formulimit të pyetjeve. Çdo skuadër nxjerr konkluzionet e punës në grup dhe tregon nëse bashkëpunimi e arriti rezultatin. Nëse jo duhet të tregojnë se cilat ishin arsyet. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;<br>▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;<br>▪ në realizimin e detyrës së dhënë. |

## *35. Planifikimi ditor* *data............................*

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: IX |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>**Tema mësimore**: Ekspozita e fundvitit. Projekt | | **Situata e të nxënit: Diskutime mbi mënyrën e përgatitjes së ekspozitës**<br>Nxënësit ndahen në tre skuadra dhe secila prej tyre përzgjedh punimet e një periudhe. Ata/ato diskutojnë së bashku mbi mënyrën e ekspozimit të punëve të përzgjedhura.<br>Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et në një situatë pune të përbashkët ku bashkëpunimi është çelësi i organizimit të një ekspozite të mirë. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>Nxënësi/ja:<br>- zhvillon aftësitë komunikuese dhe ndërvepruese;<br>- diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për ndarjen e punës;<br>- përzgjedh punimet për ekspozim sipas tematikave të caktuara;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për realizimin e ekspozitës. | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- përzgjedhja e punimeve;<br>- ekspozita;<br>- organizimi i ekspozitës. | |

| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- punimet e nxënësve;<br>- mjete të nevojshme për realizimin e ekspozitës. | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare*:**<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare*:**<br>- njohja e kulturave. |
|---|---|
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nxënësit ndahen në tri skuadra dhe secila prej tyre përzgjedh punimet e një periudhe. Ata/ato diskutojnë së bashku mbi mënyrën e ekspozimit të punëve të përzgjedhura. Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et në një situatë pune të përbashkët ku bashkëpunimi është çelësi i organizimit të një ekspozite të mirë. | |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Pasi skuadrat kanë përcaktuar hapësirat e tyre për ekspozim dhe kanë përzgjedhur punimet, i vendosin ato në tabakë kartoni. Më pas i vendosin në muret e klasës. Nëpërmjet ekspozitës nxënësit/et shohin rrugëtimin e tyre gjatë një viti në lëndën e artit pamor. Ata/ato diskutojnë mbi punimet e tyre dhe mënyrën e realizimit. Nxënësit/et nxjerrin përfundimet e punës në grup duke u shprehur nëse bashkëpunimi e arriti rezultatin dhe nëse ekspozita ia arriti qëllimit (të pasqyronte ecurinë e nxënësve në këtë lëndë gjatë këtij viti). | |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;<br>▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;<br>▪ në realizimin e detyrës së dhënë. | |

# 4. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

## 4.1 Metodologjia e të nxënit dhe mësimdhënies bazuar në kompetenca në lëndën e artit pamor

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënien e artit pamor është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve/eve, duke i dhënë secilit/secilës mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin pamor/artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të artit pamor do të thotë që nxënësit/et të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata/ato zbulojnë mjedisin vizual dhe krijojnë nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet një motivimi të drejtë dhe përkundrejt zhvillimit të një kompetence të caktuar, nëpërmjet rezultateve të të nxënit dhe tematikave përkatëse mësimore. Mësimdhënia e artit pamor, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari emocionale dhe fizike. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore në artin pamor është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit/et drejtohen drejt një veprimtarie në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potencialit të tyre intelektual/artistik në shumë aspekte. Mësimdhënia në artin pamor synon gjithë përfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet ***në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca; mësimdhënien me në qendër nxënësin/en dhe mësimdhënien dhe nxënien e integruar***.

Nxënësit/et e një klase janë të ndryshëm/me, për sa i përket mënyrës se si ata/ato nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit/et, të pavarur/a, me anë të mjeteve konkrete etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja e strategjive dhe metodave të mësimdhënies në mësimin e artit pamor mban parasysh:

- kompetencat kryesore të të nxënit në artin pamor;
- lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- formimin dhe forcimin e aftësive bazë të artit pamor;
- rëndësinë e veprimtarive praktike në artin pamor, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet pamore me situata të jetës reale;
- rëndësinë e përdorimit të mjeteve konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- veçoritë e veprimtarive në mënyrë individuale dhe në grup;
- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së artit pamor dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të tij;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues/e-nxënës/se, në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi/ja dhe nxënësi/ja janë plotësues/e të njëri/njëra-tjetrit/tjetrës.

Një mësimdhënie e mirëmenduar dhe e mirëplanifikuar krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit/es, ashtu edhe atë të nxënësit/es. Kompetencat e artit pamor, që janë të përcaktuara në këtë program, janë të ndërlidhura dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënit, që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve/eve. Ata/Ato janë aktiv/e kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, krijime ose simulime të njohurive, interpretime, qëndrime dhe gjykime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve/eve, mësuesi/ja duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata/ato të ndihen të lirshëm/me dhe të zhdërvjellët/ta për të zhvilluar njohuritë e tyre në artin pamor.

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësi/ja të punojë me situata ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si p.sh., "..pse më pëlqen?", "...a duket bukur?", "..çfarë ndodh nëse e vendos objektin më afër?" etj. Në këtë mënyrë, ai/ajo inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e tij/saj dhe të ndërmarrë situata të reja.

Cilësia e mësimdhënies është çelësi për suksesin e fëmijëve në mësimin e artit. Mësuesit/et duhet të inkurajojnë çdo nxënës/e të besojë se do të jetë i/e suksesshëm/me në mësimin e artit, të kuptojnë interesat e nxënësve/eve, nevojat që ata/ato kanë, të ndihmojnë nxënësit/et të aktivizojnë njohuritë e mëparshme, të rendisin udhëzimet që do të përdorin, duke diferencuar udhëzimet për nxënës/e me nevoja të veçanta; po kështu mësuesit/et duhet t'i stimulojnë dhe t'i inkurajojnë të gjithë nxënësit/et, duke krijuar mjedise ku ata/ato të kenë mundësi për të eksploruar mbi artin pamor në mënyrat që për ta/to janë të rëndësishme.

Mësuesit/et mund ta realizojnë këtë nëpërmjet veprimtarive të ndryshme, duke nxitur pjesëmarrjen me eksperiencën krijuese dhe me materiale konkrete. Planifikimi i kohës, hapësira e përshtatshme dhe një shumëllojshmëri materialesh janë të rëndësishme për të mbështetur një mësimdhënie efektive. Gjatë procesit të mësimdhënies, mësuesit/et duhet të sigurojnë një shumëllojshmëri aktivitetesh të bazuara në vlerësimin e nevojave individuale të nxënësve/eve, në nevojat e grupit dhe në praktikat më të mira mësimore. Gjithashtu, mësuesit/et duhet të krijojnë një mjedis të përshtatshëm në klasë për zhvillimin e veprimtarive të "Artit pamor", që nxit idetë e reja te nxënësit/et.

Projektet kurrikulare afatgjata lejojnë nxënësin/en të aplikojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron nga njëra anë, dhe të arrij të krijojë lidhje integruese me lëndët e tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj nga ana tjetër. Edhe prezantimet e projekteve, diskutimet, debatet, gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave pamore/artistike, por mbi të gjitha të kompetencave kyçe.

## 4.2 Materiale dhe burime mësimore

Gjatë zhvillimit të mësimit në lëndën e artit pamor, për realizimin e kompetencave, mësuesi/ja përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi/ja i prek, i shikon, i përdor etj. Ai/ajo përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon ambiente për aktivitete alternative etj. Edhe teknologjia ka një ndikim të madh në artin pamor, duke ndihmuar nxënësit/et të eksplorojnë vepra arti të

ndryshme, objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të dizajnit etj., duke zhvilluar aftësitë e tyre në studimin e kësaj lënde.

Mësuesi/ja përdor fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore dhe me një fjalor të pastër të gjuhës artistike pamore. Mësuesi/ja siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Ai/Ajo u prezanton/sqaron nxënësve/eve përmbajtjet caktuara ose shkathtësitë që ata/ato duhet të performojnë.

Mësuesi/ja u krijon mundësi nxënësve/eve të demonstrojnë apo të prezantojnë me anë të mediave detyra dhe projekte të ndryshme. Mësuesi/ja duhet të demonstrojë drejtpërdrejt gjatë mësimdhënies në lëndën e "Artit pamor". Është shumë e rëndësishme për nxënësit/et e kësaj moshe lidhja midis demonstrimit të mësuesit/es dhe dhënies së mundësisë së përdorimit të njohurive dhe aftësive të tyre në veprimtarinë artistike. Në këtë mënyrë, ata/ato do të krijojnë pavarësi në përdorimin e mjeteve nga një nivel në tjetrin. Kur mësuesit/es i duhet të përdorë kontekstin kulturor të artit, duhet të marrë në konsideratë të gjitha format e artit nga e gjithë bota dhe nga kultura të ndryshme. Programi i "Artit pamor" u jep të gjithë nxënësve/eve mundësinë të zbulojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në përdorimin e një sërë mjeteve e teknikave artistike dhe të vlerësojnë veprat e artit. Klasa duhet të jetë gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit/et në orën e artit.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë: - fotografi të ndryshme që mbajnë informacionin e duhur për eksplorimin e elementeve të artit në natyrë dhe mjedisin rrethues;

- fotografi të objekteve të ndryshme të artizanatit, të trashëgimisë kulturore etj.;
- riprodhime të veprave të artit dhe postera;
- *mjetet audiovizive si:* TV, video, video-projektor, kompjuter, internet, *CD, DVD*;
- *mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve/eve dhe për të demonstruar vepra të ndryshme arti, artizanati, dizajni etj. Këto burime duhet të diskutohen dhe të vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për artin pamor. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit/et në punët e tyre krijuese.
- *mjedisi mësimor:* klasa, kabinetet e artit pamor etj.

# 5. VLERËSIMI

## 5.1. Llojet e vlerësimit: Vlerësimi i vazhdueshëm, periodik dhe përfundimtar

**Vlerësimi tremujor**

**Vlerësimi periodik tremujor përfshin:**

- *Vlerësimin e vazhdueshëm* që del nga evidencat e vlerësimit të vazhduar të mbajtura për periudhën tremujore.
- *Vlerësimin me detyrë* përmbledhëse në përfundim të periudhës tremujore.
- *Vlerësimin e dosjes (portofolit) së nxënësit/es* për periudhën tremujore.

Këto vlerësime shënohen në regjistër në kolonat përkatëse në përfundim të çdo tremujori.

**Vlerësimi përfundimtar**

Vlerësimi përfundimtar kryhet në përfundim të vitit shkollor. Nota vjetore përfundimtare përfshin:

- *Notën vjetore të vlerësimit të vazhdueshëm* të tri periudhave tremujore.
- *Notën vjetore të vlerësimit me detyrë përmbledhëse* të tri periudhave tremujore.
- *Notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit/es* të tri periudhave tremujore.

Secili lloj i vlerësimit në notën vjetore përfundimtare ka peshën e vet në përqindje.

**Tabela: Peshat në përqindje të llojeve të vlerësimit**

| **Lloji i vlerësimit** | **Pesha në përqindje** |
|---|---|
| Vlerësimi i vazhdueshëm | 40% |
| Vlerësimi me detyrë përmbledhëse | 40% |
| Vlerësimi i dosjes (portofolit) së nxënësit/es | 20% |

Hapat për njehsimin e notës vjetore përfundimtare janë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhdueshëm (NVV).
- Përcaktohet nota vjetore e detyrës përmbledhëse (NVP).
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit/es (NVP).
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë.

(p.sh: nota 6,4 rrumbullakoset 6; nota 6,5 rrumbullakoset 7).

**(NVV x 0,4) + (NVP x 0,4) + (NVP x 0,2) = Nota vjetore përfundimtare**

**Shembull**:

| **Tremujori I** | | | **Tremujori II** | | | **Tremujori III** | | | **Nota vjetore** | | | **Nota vjetore përfundimtare** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| NVV | NVT | NVP | NVV | NVT | NVP | NVV | NVT | NVP | NVV | NVT | NVP | |
| 8 | 9 | 10 | 9 | 10 | 10 | 8 | 10 | 10 | 8 | 10 | 10 | |

(8 x 0,4) + (10 x 0,4) + (10 x 0,2) = 9,2
**Nota vjetore përfundimtare 9**

(Footnotes)

1 Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme mund të përdoren për të ilustruar njohuritë në tematikat “Gjuha dhe komunikimi artistik” dhe “Teknika dhe procese artistike”.